



UNITED NATIONS
ALBANIA



unicef 
for every child



Kingdom of the Netherlands

Tetor

20

20

MANUALTRAJNIMI “PËRDORIMI I TIK-UT NË PROCESIN E MËSIMDHËNIE–NXËNIES”

(Në ndihmë të mësuesve të shkollave në
arsimin parauniversitar)



Manuali “Përdorimi i TIK-ut në procesin e mësimdhënie – nxënies” u hartua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) në bashkëpunim me Zyrën e UNICEF-it në Shqipëri me mbështetjen e SDG Fund nëpërmjet financimit të qeverisë holandeze.

Grupi i punës u udhëhoq nga:

Z. Gerti Janaqi, drejtor i përgjithshëm i ASCAP

Znj. Mirlinda Bushati, specialiste e edukimit në UNICEF

Znj. Dorina Rapti, drejtor i kurrikulës dhe i kualifikimit në ASCAP

Znj. Erida Koleci, specialiste e kurrikulës dhe e trajnimit në ASCAP

Znj. Ines Todhe, specialiste e kurrikulës dhe e trajnimit në ASCAP

Znj. Evis Mastori, specialiste e kurrikulës dhe e trajnimit në ASCAP

Znj. Marina Topulli, specialiste e kurrikulës dhe e trajnimit në ASCAP

Në hartimin e manualit kanë kontribuar pedagogë të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të fakulteteve të mësuesisë, specialistë të ASCAP-it, specialistë të TIK-ut pranë drejtorive arsimore rajonale, mësues të arsimit parauniversitar, përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile etj., ndër të cilët: Mirjana Canellari, Nikolin Gërmjenji, Eriksen Mersinllari.

Materiali i paraqitur në këtë botim u përket autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht këndvështrimet e UNICEF-it.

Manuali dhe veprimtaritë praktike janë mbështetur në Kornizën Evropiane për Kompetencën Digjitale të Mësuesve, DigComEdu¹ si dhe në Kornizën e Kompetencës së TIK-ut Për mësuesit,(ICT CFT, version 3, UNESCO),² i cili është një dokument që shërben për të udhëhequr zhvillimin e mësuesve në përdorimin e TIK-ut. Kjo kornizë ka për qëllim të mbështesë vendet në zhvillimin e politikave dhe në ndërtimin e kapaciteteve profesionale në fushën e TIK-ut në arsim.

© Copyright 2020 Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për ASCAP-in dhe UNICEF-in, Tiranë, Shqipëri

¹<https://ec.europa.eu/jrc/en/digcompedu>

²https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000265721_eng

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	HYRJE	4
II.	ROLI DHE NEVOJAT E MËSUESVE NË SHEKULLIN XXI	5
2.1	Kompetenca e të nxënit gjatë gjithë jetës.....	5
2.2	Kompetenca digjitale e shekullit XXI	6
2.3	Roli i mësuesit.....	8
2.4	Nevoja për përmirësimin profesional të mësuesve lidhur me zhvillimin e kompetencës digjitale	11
2.5	Ngritja e kapaciteteve për përdorimin e TIK-ut në shkollë.....	12
3	KORNIZA E STANDARDEVE TË PËRDORIMIT TË TIK-ut NË PROCESIN E MËSIMDHËNIE – NXËNIES	13
3.1	Pse standarde për mësuesit në përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor?.....	13
3.2	Kujt i shërbejnë këto standarde?	14
3.3	Rëndësia e hartimit të standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut.....	15
3.4	Korniza e standardeve të mësuesit për përdorimin e TIK-ut	15
3.5	Vetëvlerësimi i mësuesit duke u bazuar në standardet profesionale.....	16
4	PLANIFIKIMI EFEKTIV PËR ZBATIMIN E TIK-UT NË SHKOLLË	17
4.1	Çfarë është një planifikim efektiv për zbatimin e TIK-ut në shkollë?	17
4.2	Zhvillimi i një vizioni për teknologjinë në nivel shkolle	18
4.3	Mbrojtja dhe siguria nga përdorimi i teknologjive të reja.....	20
5	METODOLOGJIA DHE TIK-U NË PROCESIN MËSIMOR	23
5.1	Ndikimi i TIK-ut në përmirësimin e metodave të mësimdhënie - nxënies.....	23
5.2	Përdorimi efektiv i TIK-ut në procesin e mësimdhënie - nxënies.....	24
5.3	Zhvendosja e qasjes së mësuesit dhe nxënësit në procesin e mësimdhënie - nxënies....	26
6.	VEPRIMTARIP PËR TRAJNIMIN E MËSUESVE NË PËRDORIMIN E TIK-ut NË PROCESIN E MËSIMDHËNIE – NXËNIES.....	27
	Veprimtaria 1 Vetëvlerësimi i nevojave për zhvillim profesional të mësuesit bazuar në standardet e TIK 27	
	Veprimtaria 2: Terminologjia bazë për kompjuterin.....	29
	Veprimtaria 4: Si mund të përdoret kompjuteri në klasë?	34
	Veprimtaria 5: Krijimi, redaktimi, formatimi dhe printimi i një dokumenti në Word.....	35
	Veprimtaria 7 Vlerësimi i mjeteteve online të TIK-ut për vlerësimin e nxënësve në klasë.....	38
	Veprimtaria 8 Vlerësimi i platformës moodle.....	39
	Veprimtaria 9 Përdorimi i platformës Google forms për ndërtimin e pyetjeve.....	41
	Veprimtaria 10: Përdorimi i TIK-ut për kryerjen e detyrave rutinë të mësuesit.....	43
	Veprimtaria 11: Përdorimi i TIK-ut për zhvillimin profesional të mësuesit.....	44
	Veprimtaria 12: Siguria në mjediset digjitale	45
7.	QYTETARIA DIGJITALE.....	47
8.	BIBLIOGRAFIA.....	50

I. HYRJE

Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit (TIK) ka transformuar çdo aspekt dhe fushë të jetës sonë. Ndikimi i TIK-ut në mjekësi, turizëm, biznes, drejtësi, inxhinieri, arkitekturë etj., gjatë dekadave të fundit ka qenë i mahnitshëm. Mënyra se si këto fusha operojnë sot ndryshon shumë nga e kaluara.

Pjesë e këtij ndryshimi është edhe arsimi. TIK ka ndikuar shumë në mënyrën e ofrimit të shërbimit arsimor, pasi ka potencialin t'u sigurojë nxënësve të mësuarin gjatë gjithë jetës, pjesëmarrjen e plotë në shoqëri dhe suksesin në jetën profesionale. Përmbushja e këtij qëllimi dikton zhvillimin e njohurive dhe të aftësive digjitale të nxënësve dhe të mësuesve. Nxënësit sot jetojnë dhe rriten në një botë digjitale, megjithatë edhe ata kanë nevojë mbështetje në zhvillimin e kompetencës digjitale. Studimet tregojnë se nxënësit e përdorin teknologjinë më shumë në aktivitetet e kohës së lirë jashtë shkollës, se sa në procesin e të nxënës. Gjithsesi, sfida më e madhe është për mësuesit. Përveç aftësive TIK të domosdoshme për jetën e përditshme, mësuesit kanë nevojë për kompetenca specifike digjitale që u mundësojnë atyre që ta përdorin teknologjinë për të mbështetur, përmirësuar dhe transformuar procesin e mësimdhënie-nxënies, si dhe për përgjegjësitë e tjera në shkollë.

Në nivelin evropian, këto kompetenca janë përfshirë në një kornizë kompetencash për mësuesit (Korniza evropiane për kompetencën digjitale të mësuesve, DigComEdu³). Po kështu edhe UNESCO ka hartuar Kornizën e kompetencës së TIK-ut për mësuesit (ICT CFT, version 3),⁴ si një dokument për të udhëhequr zhvillimin e mësuesve në përdorimin e TIK-ut. Kjo kornizë ka për qëllim të mbështesë vendet në zhvillimin e politikave dhe në ndërtimin e kapaciteteve profesionale në fushën e TIK-ut në arsim.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) duke u mbështetur në prirjet globale të arsimit sot, e ka vendosur integrimin e TIK-ut dhe digjitalizimin e arsimit si prioritet në strategjinë për zhvillimin e arsimit parauniversitar.

Pavarësisht arritjeve në nivel evropian dhe kombëtar, përfshirja efektive e TIK-ut në arsim mbetet ende sfidë. Përmirësimi i infrastrukturës digjitale, zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve dhe i drejtuesve të shkollave, mirëmbajtja e pajisjeve etj., vazhdojnë të mbeten përparësi për të ardhmen.

Kësaj domosdoshmërie i mbivendoset situata e krijuar nga pandemia COVID-19, e cila ka detyruar qeveritë e vendeve të ndryshme të mbyllin institucionet arsimore për të parandaluar përhapjen e virusit dhe ta vazhdojnë procesin mësimor online. Kjo formë i përballi mësuesit në


³<https://ec.europa.eu/jrc/en/digcompedu>

⁴https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000265721_eng

mënyrë të beftë dhe të menjëhershme, me kontekstin e ri global të mësimdhënies online. Ata po shkojnë drejt këtyre rrethanave të reja jo pa vështirësi dhe shpesh po përjetojnë pasiguri, lodhje emocionale, ankth dhe stres. Këto pasoja vijnë për shkak të infrastrukturës së pamjaftueshme të TIK-ut, mungesës së trajnimit, mjedisit kompleks të mësimin në kushtet e shtëpisë etj.

Për t'u ardhur në ndihmë mësuesve të shkollave në të gjithë sistemin arsimor parauniversitar, por edhe të interesuarve të tjerë, ASCAP ka hartuar manualin e trajnimit "Përdorimi i TIK-ut në procesin e mësimdhënie-nxënies".

Në këtë manual janë trajtuar aspekte teorike dhe praktike në lidhje me përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor.



Ky manual nuk do të jetë i vetmi material ndihmës për mësuesit e shkollave. Teknologjia ndryshon vazhdimisht ndaj nevoja për mbështetje do të vijojë. Në varësi të nevojave dhe të risive do të ofrohen trajnime dhe materiale të tjera ndihmëse.

II. ROLI DHE NEVOJAT E MËSUESVE NË SHEKULLIN XXI

2.1 Kompetenca e të nxënit gjatë gjithë jetës

Të nxënit gjatë gjithë jetës përshkruhet si një proces që përfshin nxënien në mënyrë të vazhdueshme, vullnetare dhe në kontekste të ndryshme. Mjediset ku zhvillohet procesi i të nxënit gjatë gjithë jetës nuk përfshijnë vetëm shkollat, por edhe shtëpitë, vendet e punës, madje edhe vendet ku njerëzit ndjekin aktivitete të kohës së lirë.

Një karakteristikë e shoqërisë së informacionit është që individi të mësojë gjatë gjithë jetës. Sipas Crowther (2004:130) në shoqërinë e informacionit, individi duhet të kuptojë, të interpretojë dhe të përdorë të dhëna shkencore, të krijojë ide të reja dhe të ketë aftësi për të

zgjidhur problemet. Pa këto aftësi, mundësia e të nxëniet zvogëlohet ose individi me shumë përpjekje mund të mësojë pak ose aspak (Cornford, 2002).


Me zhvillimin e shoqërisë, e kemi të pamundur të vazhdojmë të ecim me ritmet e së shkuarës. Individët që e humbasin këtë zhvillim e ndryshim janë të përjashtuar në shoqërinë e sotme. Arsimi më shumë se çdo fushë duhet t'u përgjigjet kërkesave të kohës ndaj ndryshimeve të shpejta të shoqërisë dhe të reflektojë në hartimin e politikave dhe një vizioni të ri për të mësuarit gjithëpërfshirës dhe gjatë gjithë jetës.

2.2 Kompetenca digjitale e shekullit XXI

Kompetenca digjitale⁵ është njëkohësisht kërkesë dhe e drejtë e qytetarëve, n.q.s. ata duan të jenë funksional në shoqërinë e sotme.

Koncepti i kompetencës digjitale sipas UNESCO-s

Kompetenca digjitale është një objektiv lëvizës shumëplanesh, i cili mbulon shumë fusha dhe zhvillimin e shpejtë të teknologjive të reja që shfaqen.




Të gjitha këto aftësi i përkasin disiplinave të ndryshme: studimeve të medieve, shkencave të informacionit dhe teorive të komunikimit, të cilat duhet të jenë pjesë e shkollës për përgatitjen e qytetarëve të ardhshëm, funksionalë në një shoqëri globale.

Kurrikula, si komponenti kyç i arsimit, është e hapur të pasqyrojë nevojat e shoqërisë nëpërmjet përmbajtjes dhe procesit të saj. Kurrikula në çdo nivel shkollimi siguron përvojën e të mësuarit

⁵Digital Competence in Practice: An Analysis of Frameworks

dhe atë lloj të mësuarit që do t'i zhvillojë individit aftësi funksionale dhe personale për t'u përshtatur sa më shpejt dhe në mënyrë sa më cilësore me kërkesat e shoqërisë së shekullit të 21-të.



Kompetenca digjitale është aftësia:

- për të përdorur teknologjinë digjitale dhe mjetet e komunikimit;
- për të marrë informacion;
- për të menaxhuar dhe integruar informacionin;
- për të vlerësuar informacionin;
- për të përshtatur informacionin;
- për të shkëmbyer informacione në mënyrë që individit të funksionojë në shoqërinë digjitale.

Elementet, përshkrimi dhe shkathtësitë në kompetencën digjitale janë dhënë në tabelën e mëposhtme

Elementet	Përshkrimi	Shkathtësitë
Akses	Mësuesi mbledh dhe organizon informacionin. Ai zhvillon dhe zbaton një strategji sistematike për të gjetur, për të nxjerrë dhe për të klasifikuar informacionin nga burime të ndryshme, të cilat përfaqësojnë një spektër të gjerë për të marrë parasysh burimin e përshtatshëm.	Mësuesi kërkon, gjen dhe përzgjedh informacionin në mjedise digjitale.

Menaxhimi	Mësuesi zhvillon, kategorizon dhe klasifikon informacionet, në mënyrë që të identifikojë dhe të qartësojë lidhjet mes tyre.	Mësuesi kryen një organizim fillestar dhe paraprak të informacionit, në mënyrë që të arrijë zbatimin e tij.
Integrimi	Mësuesi interpreton informacion e mbledhur. Ai sintetizon informacionin e marrë nga shumëllojshmëri burimesh, krahason dhe argumenton ndryshimet, identifikon prirjet dhe modelet, duke dalë më pas në përfundime.	Mësuesi interpreton dhe paraqet informacionin duke përdorur mjetet e TIK-ut për të sintetizuar, për të përmbledhur, për të krahasuar dhe për të identifikuar informacionin e saktë.
Vlerësimi	Mësuesi merr vendime në lidhje me cilësinë, rëndësinë, dobinë ose efikasitetin e informacionit.	Mësuesi gjykon vërtetësinë e informacionit, i jep përparësi informacionit nga burime reale dhe e plotëson atë me burime shtesë për një qëllim të caktuar.
Krijimi	Mësuesi gjeneron informacionin e marrë duke e përshtatur, hartuar, rikonceptuar dhe zbatuar.	Mësuesi gjeneron informacione të reja për nxënësit nëpërmjet rishikimit kritik të informacionit të asimiluar. Ai zhvillon argumente të mbështetura në konkluzionet e nevojshme.
Komunikimi	Mësuesi komunikon informacione bindëse për të plotësuar nevojat e ndryshme të audiencës.	Mësuesi komunikon, përshtat dhe prezanton informacionin në kontekstin e duhur (të pranishmëve dhe të kolegëve), në mjediset e TIK-ut.

2.3 Roli i mësuesit

Roli i mësuesit⁶ ka ndryshuar dhe vazhdon të ndryshojë nga ajo e instruktorit në atë të ndërtuesit të njohurive, lehtësuesit, trajnerit dhe krijuesit të mjediseve mësimore. Teknologjitë e reja arsimore nuk e përjashtojnë nevojën e mësuesit në klasë, por ato kërkojnë një ridimensionim të profesionit të tij.

Nuk është më e mjaftueshme për mësuesit dhënia e përmbajtjes së njohurive. Ata duhet të inkurajojnë nivele të larta të aftësive njohëse, të nxisin leximin e informacionit dhe të ushqejnë praktika bashkëpunuese të punës. Këto përgjegjësi të reja janë lehtësuar nga përdorimi i TIK-

⁶ Teachers' role and needs in the ICT environment

ut në mësimdhënie. Megjithatë, një integrim i vërtetë i TIK-ut kërkon trajnimin e mësuesve në këtë drejtim.

Kërkesa të reja për mësuesin sot:





Tabela e mëposhtme identifikon ndryshimin që duhet të ndodhë nga një fokus në mësimdhënie në fokusin te të nxënit.

	Mjedisi me fokus mësimdhënien	Mjedisi me fokus të nxënit
Aktivitetet në klasë	Mësuesi në qendër	Nxënësi në qendër

Roli i mësuesit	Tregon, shpjegon Gjithmonë mësuesi ekspert	Bashkëpunues, Disa herë janë edhe nxënësit
Udhëzimet	Memorizim i fakteve	Marrëdhënie Hulumtim dhe shpikje
Koncepti i njohurisë	Mbledhje e fakteve Kuptim sasior	Transformim i fakteve
Demonstrimi i suksesit	Referencë ndaj notës	Cilësia e të kuptuarit
Vlerësimi	Pyetje – përgjigje	Kritere të përcaktuara Portofol dhe performancë
Përdorimi i teknologjisë	Njeh dhe praktikon	Komunikon, krijon akses, bashkëpunon

Zhvendosja e theksit nga mësimdhënia në të nxënës mund të krijojë më shumë mjedis interaktiv dhe tërheqës për mësimin, si për mësuesit ashtu edhe nxënës. Ky mjedis i ri përfshin gjithashtu një ndryshim në rolet e mësuesve dhe të nxënësve. Roli i mësuesit do të ndryshojë nga transmetuesi i njohurive në atë të nxënës, lehtësuesi, manuali i njohurive, navigatori i njohurive dhe bashkë-nxënës me nxënësin. Roli i ri nuk e zvogëlon rëndësinë e mësuesit por kërkon njohuri dhe aftësi të reja. Nxënësit do të kenë përgjegjësi më të madhe për mësimin e tyre në këtë mjedis ndërsa kërkojnë, gjejnë, sintetizojnë dhe ndajnë njohuritë e tyre me të tjerët. TIK-u siguron mjete të fuqishme për të mbështetur kalimin në të nxënës me në qendër nxënësin dhe rolet e reja të mësuesit dhe nxënës.

*Duke supozuar rolet e reja të tyre, mësuesit kanë nevojë për **zhvillim të vazhduar profesional**, që të përmirësojnë njohuritë e tyre dhe të fitojnë aftësi të reja në këto fusha:*

Pedagogji: Mësuesit kanë nevojë për aftësi të reja pedagogjike në mënyrë që ata të përdorin potencialin e teknologjisë për të përmirësuar procesin e mësimdhënie-nxënies.

Zhvillimi i kurrikulave: Mësuesit duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë kurrikula efektive të përshtatshme, të cilat u krijojnë mundësi nxënësve për të ndërtuar kuptimin, për të integruar njohuri të reja në mjediset e tyre dhe për të komunikuar njohuritë e reja.

Integrimi i plotë në kurrikul: Strategjitë janë të domosdoshme për të integruar në mënyrë kuptimplotë teknologjinë në kurrikul. Teknologjia duhet të konsiderohet si metodologji dhe jo të trajtohet thjesht si një lëndë më vete. Në veçanti, mësuesit duhet të aftësohen për të zhvilluar strategji afatgjata për përdorimin e teknologjisë gjatë procesit mësimor për të mbështetur,

zhvilluar dhe lehtësuar përvetësimin e njohurive dhe aftësive dhe për të përmbushur qëllimet dhe rezultatet e të nxënit.


Zhvillimi i stafit: Aktivitete që ofrojnë aftësi në përdorimin e aplikacioneve dhe software-ve. Suksesi i nxënësve varet nga mësuesi, i cili përdor teknologji për të mbështetur të nxënit dhe për të zhvilluar projekte ndërkurrikulare. Këto projekte duhet të jenë të lidhura ngushtë me njohuritë, aftësitë dhe përmbushjen e rezultateve të të nxënit të programit mësimor lëndor.

Sistemi mbështetës: Mësuesit duhet të kenë mbështetje si në shkolla dhe në nivele të ndryshme rajonale për integrimin e teknologjisë në klasë, për të kapërcyer izolimin e për t'u ballafaquar me qasje dhe mjetet të reja metodologjike të panjohura më parë në procesin mësimor. Përdorimi i teknologjisë dhe i mjeteve të saj në klasë të tilla si: hardware, software, etj., kërkon kohë dhe mbështetje teknike për zhvillimin profesional të mësuesit.

2.4 Nevoja për përmirësimin profesional të mësuesve lidhur me zhvillimin e kompetencës digjitale

Mësuesit luajnë rol të rëndësishëm në përdorimin e efektshëm të TIK-ut për qëllime arsimore. Formimi fillestar i mësuesve, trajnimi për mësuesit në detyrë dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional kontribuojnë në krijimin e kompetencave digjitale të mësuesve. Për këtë arsye u hartuan standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut, të cilat shërbejnë si orientim për hartimin e programeve për formimin fillestar të mësuesve dhe zhvillimin profesional, si dhe për vlerësimin e performancës së tyre.

Hartimi i këtij dokumenti pasohet nga veprimtari të tjera:



2.5 Ngritja e kapaciteteve për përdorimin e TIK-ut në shkollë

Ngritja e kapaciteteve nënkupton një grup trajnerësh kombëtarë, të cilët janë në gjendje të ndihmojnë trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve për t'u aftësuar në përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie. Ngritja e këtyre kapaciteteve fokusohet në çështjet e mëposhtme:

- ✓ *Njohja me standardet e kompetencave të mësuesve:* Trajnuesit janë të familjarizuar me kompetencat e mësuesve për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie. Ata shpjegojnë standardet e mësuesit për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie gjatë trajnimeve, si dhe vënë në dispozicion materiale ndihmëse dhe literaturë nga kornizat e sistemeve arsimore të shteteve të tjera për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie.
- ✓ *Prezantimi i praktikave më të mira të përdorimit të TIK-ut në klasë:* Harta digjitale përmban korniza të përdorimit të TIK-ut në sisteme të ndryshme arsimore. Modulet e TIK-ut shërbejnë për trajnimin e mësuesve. Trajnuesit janë të hapur të mbështesin mësuesit me literaturë ndihmëse.
- ✓ *Vlerësimi dhe certifikimi:* Trajnuesit janë të hapur të bëjnë certifikimin e mësuesve sipas një testimi të përgatitur brenda standardeve.

3 KORNIZA E STANDARDEVE TË PËRDORIMIT TË TIK-ut NË PROCESIN E MËSIMDHËNIE – NXËNIES

3.1 Pse standarde për mësuesit në përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor?

Jetojmë në epokën digjitale ku nga njëra anë kemi nxënësit, të cilët janë përdorues shumë të mirë të teknologjisë, ndërsa në anën tjetër ndeshemi me mësues, të cilët akoma nuk kanë aftësitë e duhura për t’iu përgjigjur sfidave të kohës për një mësimdhënie dhe nxënie moderne me bazë të gjerë integrimin dhe përdorimin e TIK-ut.

Mësuesi është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Shkollat dhe klasat, si ato reale ashtu edhe ato virtuale, duhet të kenë mësues të pajisur me shkathtësi teknologjike të cilët duhet të dinë se ku dhe kur duhet përdorur TIK-u gjatë procesit të mësimdhënies.

Një mësuesi për të qenë i aftë në punën e tij nuk i duhet të zotërojë vetëm lëndën, por edhe të dijë ta transmetojë atë sa më lehtësisht te nxënësi, nëpërmjet metodologjive bashkëkohore, ku TIK-u ka vlera të domosdoshme dhe të patjetërsueshme për të transformuar mjedisin profesional të mësimdhënie-nxënies. TIK-u nuk ndikon vetëm në një mësimdhënie të suksesshme, por dhe në mundësitë që u krijojnë mësuesve për të mësuar dhe për të bashkëpunuar me njëri – tjetrin, nëpërmjet shkëmbimit të ideve, përvojave dhe zgjidhjes së problemeve të përbashkëta pedagogjike.

Në të gjitha vendet evropiane e më gjerë, TIK është bërë pjesë e domosdoshme e kurrikulave, si një metodologji e re për integrimin e tij në mësimdhënie. Për këtë arsye Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO) dhe Shoqata Ndërkombëtare për Teknologjinë e Edukimit (ISTE), kanë përgatitur paketa standardesh të TIK-ut për mësuesit. Këto paketa standardesh u kanë siguruar shteteve, rajoneve, shkollave dhe institucioneve të edukimit, themele mbi të cilat ngrihet filozofia dhe hartohen plane për integrimin e TIK-ut në kurrikul.

Në këto kushte dhe në Shqipëri shtrohet si domosdoshmëri miratimi i standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie – mësimnxënie, për t’u siguruar që të gjithë mësuesit të jenë të mirëpërgatitur për të përdorur TIK-un në procesin mësimor me qëllim përgatitjen dhe aftësimin e nxënësve me aftësitë e shekullit XXI. Integrimi me sukses i TIK-ut në klasë do të varet nga aftësia e mësuesve për të strukturuar mjedisin e të nxënësve, për të shkrirë teknologjinë e re me metodologjinë, për të zhvilluar klasa aktive, për të nxitur ndërveprimin, të nxënësve bashkëpunues dhe punën në grup.

Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie - nxënie kanë për qëllim të sigurojnë një qasje të standardizuar për të gjithë mësuesit, në lidhje me përdorimin e TIK-ut në shkollë dhe në procesin mësimor. Këto standarde përcaktojnë treguesit për zbatimin

e TIK-ut në procesin mësimor, si dhe synojnë të përgatisin mësuesit për t'u bërë përdorues të teknologjive të ndryshme të komunikimit dhe të informimit.

3.2 Kujt i shërbejnë këto standarde?

Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut përshkruajnë atë që pritet të njohë, të kuptojë, të zotërojë dhe të demonstrojë mësuesi në lidhje me integrimin dhe përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie-nxënies.

- a) Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut i shërbejnë në radhë të parë **vetë mësuesit**. Mësuesi mbështetet në to për të vlerësuar performancën e tij, duke dalluar anët e tij të forta dhe nevojat, si dhe për të kuptuar më mirë përparimin e tij profesional. Standardet përfshijnë një sërë treguesish të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve, për të cilat mësuesi tregon angazhimin për kryerjen me sukses të rolit të tij në shkollë. Përmbushja e standardeve mbështet mësuesin për progresin e tij në karrierë dhe për kualifikimin e tij.
- b) Standardet profesionale të mësuesit i shërbejnë **drejtuesit të shkollës** në mënyrë që të përmbledhë nevojat profesionale të mësuesve dhe mbi këtë bazë të hartojë dhe zbatojë planin e zhvillimit profesional të tyre.
- c) Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut i shërbejnë **këshillit të mësuesve dhe ekipeve lëndore**, të cilët mund t'i përdorin këto standarde për përmirësimin e procesit të mësimdhënie-nxënies dhe zhvillimin e vazhduar profesional të mësuesve.
- d) Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut i shërbejnë institucionit vendimmarrës dhe politikëbërës, **Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)** për formulimin e politikave mbarëkombëtare të zhvillimit profesional të mësuesve, si dhe për të hartuar udhëzime, urdhra dhe rregullore që kanë të bëjnë me mësuesit dhe përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie/nxënies.
- e) **Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)** mbi bazën e standardeve identifikon nevojat e mësuesve për zhvillim profesional dhe harton programe e module trajnimi në nivel kombëtar. Gjithashtu, ky institucion ndihmon mësuesit dhe shkollat në vlerësimin e performancës së tyre.
- f) **Njësitë arsimore vendore (DRAP/ZVAP-të)** mbështetur në standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut hartojnë planet e zhvillimit profesional të mësuesve, si dhe planifikojnë veprimtaritë e rrjeteve profesionale.
- g) **Fakultetet e edukimit** mbështeten në këto standarde për të hartuar në koherencë standardet e formimit fillestar të mësuesve, si dhe për të mundësuar përmes kurrikulës përkatëse përgatitjen e mësuesve në lidhje me to.

- h) **Organizatat dhe institucionet** që punojnë në fushën e arsimit mund ta përdorin dokumentin e standardeve në mënyrë që të ideojnë bashkëpunime të suksesshme me institucionet arsimore dhe që të për zgjedhin më mirë kontributet e tyre në arsim.

3.3 Rëndësia e standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut

Standardet e mësuesit për përdorimin e TIK-ut kanë për qëllim dhënien e **koncepteve, njohurive, aftësive** që duhet të zotërojë mësuesi për zbatimin dhe integrimin e teknologjisë në procesin mësimor. Ky set standardesh synon të përgatitë mësuesit për të përdorur TIK-un si metodologji apo si mjet në procesin mësimor. Këto standarde aftësojnë mësuesit për:

- marrjen e informacionit dhe njohurive nga burime të ndryshme;
- komunikimin dhe shkëmbimin e njohurive;
- efikasitetin e përdorimit të TIK në procesin e mësimdhënies.

Standardet e TIK-ut për mësuesit në procesin mësimor synojnë :

- ✓ zhvillimin profesional të mësuesve në të tërë nivelet e arsimit parauniversitar për përdorimin e teknologjisë;
- ✓ pajisjen e mësuesve me aftësitë e duhura për të zbatuar teknologjitë e reja me bazë TIK-un gjatë gjithë procesit mësimor;
- ✓ rritjen e aftësive sociale dhe komunikuese të mësuesve;
- ✓ përdorimin e rrjeteve për të shkëmbyer informacione, për bashkëpunime mes kolegësh dhe ekspertësh të jashtëm duke nxitur zhvillim profesional të tyre;
- ✓ përdorimin nga mësuesit të programeve kompjuterike për prezantime të ndryshme;
- ✓ njohjen dhe përdorimin e internetit nga mësuesit për qëllime mësimore;
- ✓ njohjen dhe zbatimin nga mësuesit të metodave interaktive e multimediale gjatë procesit mësimor.

3.4 Korniza e standardeve të mësuesit për përdorimin e TIK⁷-ut

Korniza e standardeve të mësuesit për përdorimin e TIK përmban lidhjen e fjalëve kyç të standardeve të mësuesit për përdorimin e TIK me fazat e zhvillimit të këtyre standardeve.

Fjalët kyç	Njohuri dhe aftësi bazë në përdorimin e TIK	Njohuri dhe aftësi më të thelluara në përdorimin e TIK	Njohuri dhe aftësi krijuese në përdorimin e TIK
Fazat e zhvillimit			
Njohja dhe zbatimi i politikave	Kuptimi mbi politikat	Zbatimi i politikave	Politika inovative

⁷UNESCO, 2018 The Framework

arsimore në lidhje me TIK-un			
Përdorimi i TIK-ut në zbatimin e kurrikulës dhe në vlerësimin e nxënësve	<i>Përvetësimi i njohurive bazë</i>	<i>Zbatimi i njohurive</i>	<i>Zhvillimi i aftësive të shoqërisë së dijes</i>
TIK dhe metodologjitë e mësimdhënie - nxënies	<i>Mësimdhënie e përmirësuar duke përdorur TIK</i>	<i>Zgjidhje problemore komplekse gjatë procesit të mësimdhënies</i>	<i>Vetë – menaxhimi i procesit të të nxënit</i>
Zbatimi i aftësive digjitale	<i>Zbatimi i aftësive digjitale</i>	<i>Zbatimi i elementeve të reja digjitale</i>	<i>Transformimi nëpërmjet aftësive digjitale</i>
Organizimi dhe menaxhimi i mjedisit për përdorimin e aftësive digjitale	<i>Klasë standarde</i>	<i>Klasa ka grupe bashkëpunuese</i>	<i>Klasa ka grupe të nxëni</i>
Zhvillimi profesional i mësuesit për përdorimin e aftësive digjitale	<i>Zhvillimi i aftësive bazë për përdorimin e TIK/ kompetencës digjitale</i>	<i>Krijim i rrjeteve</i>	<i>Mësues si inovator</i>

3.5 Vetëvlerësimi i mësuesit duke u bazuar në standardet profesionale

Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut u vijnë në ndihmë mësuesve për përmirësimin e cilësisë së punës së tyre dhe përmirësimin e cilësisë së procesit të mësimnxënies.

Në punën e tij, mësuesit i duhet të shqyrtojë here pas here se si po i përmbush përgjegjësitë për arritjet e nxënësve. Analiza serioze, e detajuar e periodike e vetes mbi bazën e këtyre standardeve i jep mësuesit një mundësi të çmuar për të kuptuar në kohë pikat e tij të forta dhe ato të dobëta.

Përshkrimet e mëposhtme vlejné thjesht për të ndihmuar mësuesin të vetëvlerësohet, orienton drejtuesin për të vlerësuar performancën e mësuesit, për të identifikuar nevojat për zhvillim profesional të mësuesve, si dhe për identifikimin e shpërndarjen e praktikave pozitive.

Vetëvlerësimi mund të bëhet me katër nivele dhe secilit nivel i takon një numër i caktuar pikësh. Këto nivele dhe pikët përkatëse janë:

Përshkrimi i nivelit	Niveli
Arritje shumë të mira	4
Arritje të mira që kanë nevojë për përmirësim	3
Arritje të mjaftueshme që kanë nevojë të konsiderueshme për përmirësim	2
Arritje të dobëta që kanë nevojë të domosdoshme për përmirësim	1

4 PLANIFIKIMI EFEKTIV PËR ZBATIMIN E TIK-UT NË SHKOLLË⁸

4.1 Çfarë është një planifikim efektiv për zbatimin e TIK-ut në shkollë?

Planifikimi i zbatimit të TIK-ut në shkollë përcakton synimet dhe objektivat për përdorimin e TIK-ut në kontekstin e shkollës. Ai jep udhëzime të qarta mbi llojet e pajisjeve, programeve dhe masave që nevojiten për të plotësuar kërkesat e planifikimit.

Qëllimi kryesor i planifikimit është që të ofrojë një gamë të gjerë, të balancuar dhe sfiduese të mundësive të TIK-ut për nxënësit, për t'i përgatitur ata për një rol të ardhshëm në shoqëri.

Planifikimi në shkollë përdoret:

- për të sqaruar qasjen e shkollës për mësimin dhe përdorimin e TIK-ut;
- për të ofruar udhëzime për përdorimin e TIK-ut në klasë;
- për të përcaktuar standardet e pritura dhe nivelin e objekteve dhe pajisjeve të TIK-ut;
- për të siguruar pritshmërinë se si TIK-u mund të përdoret për të mbështetur zhvillimin dhe arritjen e një nxënësi të veçantë, përfshirë këtu edhe ata me nevoja të veçanta;
- për të identifikuar infrastrukturën aktuale dhe drejtimin për zhvillimet e ardhshme të TIK-ut dhe impaktin e dëshiruar që do të ketë në të nxënësit e nxënësve;
- për të dhënë udhëzime se si TIK-u mund të integrohet në fusha të tjera;
- për të qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e ndryshme në mësimin dhe përdorimin e TIK-ut;
- për të përcaktuar pritshmërinë për monitorimin e progresit të nxënësve;

⁸Becta Schools - Leadership and management - Strategy⁹ICT Frame work, Unesco, 2018,

- për të identifikuar përgjegjësitë lidhur me mirëmbajtjen e infrastrukturës së TIK-ut në shkollë si dhe instalimin dhe mirëmbajtjen e softwer-it.

Planifikimi për përdorimin e TIK-ut në shkollë duhet të ketë një qasje të mirë me politikat e përgjithshme arsimore si kurrikulat dhe programet të cilat gjejnë zbatim në planet mësimore të shkollës. *Një planifikim efektiv i zbatimit të TIK-ut paraqet një kuadër rreth pyetjeve dhe çështjeve të mëposhtme:*

- Çfarë është mësuar?
- Si është mësuar?
- Arsyeja pse dhe si është mësuar?
- Vlerësimi i progresit të nxënësve
- Identifikimi se çfarë pajisjeje TIK-u janë të nevojshme;
- Si janë organizuar hardwerët dhe softwerët?
- Adresimi i çështjeve që lidhen me TIK-un, përfshirë sigurinë e shëndetit dhe sigurinë e përgjithshme.


4.2 Zhvillimi i një vizioni për teknologjinë në nivel shkolle

Çdo shkollë duhet të ketë një vizion për zhvillimin e teknologjisë. Një vizion efektiv i teknologjisë mbështet dhe përforcon qëllimet e shkollës në drejtim të të nxënës, të mësimdhënies, menaxhimit dhe administrimit. Përdorimi i teknologjisë mundëson që shkolla të ofrojë në çdo kohë dhe kurdoherë qasje fleksibël. Kur planifikojmë vizionin duhet të merren parasysh:

- të mësuarit në mënyrë të pavarur;
- gjithëpërfshirja;
- nevojat e arsimit special;
- siguria.

Vizioni duhet të marrë në konsideratë se si teknologjia do të kontribuojë për:

- personalizimin e një përvoje të të mësuarit që çon në përmirësimin e rezultateve të të nxënës;
- krijimin e një mjedisi fleksibël të të mësuarit, ku burimet mund të jenë të aksesueshme kudo dhe kurdoherë që nxënësit mund ti nevojiten;
- mbështetjen e të gjithë stafit përmes zhvillimit profesional, si dhe sigurimin e mjeteve për bashkëpunim, menaxhim dhe administrim;
- mundësimin e komunikimeve ndërmjet shkollës dhe prindërve, shkollave të tjera, institucioneve arsimore dhe qendrave kulturore në shërbim të fëmijëve.



Teknologjia për nxënësit:

- nxit bashkëpunimin shoqëror dhe punën në grup;
- mbështet qasjet e reja në procesin mësimor;
- lejon nxënësit të kenë akses në mënyrë që ato të studiojnë në çdo kohë dhe kudo duke përdorur një seri pajisjesh teknologjike;
- lejon nxënësit të kenë akses për sigurimin e mjeteve mësimore me cilësi të lartë;
- siguron një mjedis të sigurt duke ndaluar mundësinë e përdorimit të materialeve të papërshtatshme;
- mundëson nxënësit të ndjekin përparimin e tyre dhe të vendosin synimet e tyre;
- lejon angazhimin e prindërve në mësimin e fëmijëve të tyre.

Teknologjia për mësuesit:

- siguron që i gjithë personeli arsimor të jetë i motivuar dhe i aftë në përdorimin e teknologjisë;
- mundëson një zhvillim profesional të vazhdueshëm brenda stafit;
- mundëson mësuesit të përdorin një gamë të gjerë burimesh digjitale dhe multimediale;
- mundëson që teknologjia të përdoret në ambientet e shkollës nga grupe të ndryshme interesi;
- lejon mësuesit të krijojnë, përdorin dhe përshtatin burimet e mësimdhënies të përzgjedhur nga vetë ato si dhe nga të tjerët;
- mbështet punën e nxënësve duke planifikuar dhe i monitoruar ata.

Teknologjia për drejtuesit:

- siguron integrimin në kurrikulë bazuar në politikat për zhvillimin e TIK-ut në shkollë;

- lejon një sistem administrativ dhe financiar efikas duke përfshirë atë elektronik dhe transaksionet financiare brenda shkollës;
- siguron akses për mundësimin e të dhënave për individët (duke përfshirë pjesëmarrjen dhe sjelljen gjatë orës mësimore);
- mundëson analizën e të dhënave për të ofruar informacion në lidhje me efektivitetin e stafit dhe të performancës së nxënësve;
- mundëson mbledhjen dhe analizën e të dhënave për të siguruar informacion në lidhje me performancën e mësuesve dhe nxënësve;
- mbështet komunikimin me prindërit për të marrë informacion për frekuentimin dhe arritjet e nxënësve, si dhe për sjelljen e tyre;
- mundëson shkëmbimin e sigurt të të dhënave me shkollat e tjera, institucionet arsimore dhe qendrat kulturore të fëmijëve;

Për përcaktimin sa më të mirë të vizionit drejtuesi i shkollës duhet të këshillohet për këtë dokument me grupet e interesit të cilat përfshijnë :

- stafin
- prindërit;
- nxënësit;
- specialistët e arsimit;
- autoritet lokale;
- mbështetësit financiarë;
- etj.

Mbështetja e prindërve

Përmirësimi i cilësisë së procesit mësimor vihet re edhe gjatë bisedave të prindërve me fëmijët kur ato shkëmbejnë eksperiencat e njëri-tjetrit. Sot nxënësit nëpërmjet teknologjisë mund të sigurojnë informacione të ndryshme në çdo kohë dhe për çdo gjë. Shkollat duhet të sigurojnë raportim online për prindërit duke pasqyruar veprimtarinë ditore të fëmijëve të tyre.

4.3 Mbrojtja dhe siguria nga përdorimi i teknologjive të reja

Bota e pafundme e internetit, krahas teknologjive të mundësuarra përmes tij, vazhdon të zhvillohet me hapa të vrullshëm. Ky fenomen ka sjellë shumë përfitime, si dhe ndryshime në mënyrën përmes së cilës nxënësit mësojnë, komunikojnë dhe ndërveprojnë.

Nxënësit e sotëm janë përdorues të pasionuar dhe të përkushtuar pas Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), veçanërisht të internetit dhe teknologjive celulare. Ata konsiderohen si "digjitalë të lindur", të cilët janë gjithmonë të rrethuar nga teknologjia dhe që

e përdorin atë nga një moshë më e hershme. Përdorimi i TIK-ut shoqërohet me shumë përfitime sociale, arsimore dhe ekonomike për nxënësit.

Ata jo vetëm që janë të ekspozuar ndaj një rrjeti më të përfshirur, kanë akses në sasi të mëdha informacioni dhe janë pjesë e një komuniteti global, por edhe mund të studiojnë ose të komunikojnë kudo dhe në çdo kohë.

Megjithatë, *ekzistojnë edhe një sërë rreziqesh.*

Këtu mund të përfshihen problematikat e sigurisë, ekspozimi ndaj përmbajtjes së papërshtatshme dhe bullizmi kibernetik. Për shembull, nxënësit mund të rrezikojnë veten duke:

- u dhënë njerëzve që nuk njohin informacione personale rreth vetes;
- publikuar informacion të papërshtatshëm online;
- pranuar të takohen me njerëz që kanë njohur vetëm online, pa u këshilluar fillimisht me një nga prindërit apo kujdestarët;
- përdorur pseudonime provokuese;
- ndarë fjalëkalimet;
- postuar gjëra rreth vetes në profile publike;
- shfletuar ose kërkuar në uebsajte të pasigurta;
- u kthyer përgjigje mesazheve të papërshtatshme dhe sugjестive ose mesazheve nga njerëz të panjohur;
- aksesuar materiale të papërshtatshme ose të paligjshme.

Rreziqe të tjera lidhen me sigurinë në internet, si p.sh. viruset kompjuterike: virusi trojan dhe karremat (worms); vjedhja e identitetit dhe të dhënave; mashtrimet online dhe skemat e rreme. Nxënësit mund të jenë tejet të pasionuar pas teknologjisë, por jo gjithmonë janë të vetëdijshëm për rreziqet e sigurisë, si dhe mund të kenë vetëbesim të tepërt në aftësinë e tyre për t'i shmangur.

Bullizmi kibernetik sa vjen e shtohet dhe përbën një shqetësim në rritje në mbarë botën. Sipas studimeve të kryera, të rinjtë përdorin gjithnjë e më shumë shërbimin e mesazheve të shkurtra (SMS), mesazhimin në çast (IM), faqet e njohjeve, kamerat e telefonave celularë, emailin dhe uebsajtet për të bullizuar bashkëmoshatarët e tyre. Përpos kësaj, përdorimi në rritje i teknologjive celulare dhe të mundësuar nga interneti ka shkaktuar rreziqe të sigurisë personale.

Akresi në teknologji në shekullin e 21-të ka sjellë një kërkesë në rritje lidhur me përgatitjen e nxënësve për ta përdorur teknologjinë në mënyrë të sigurt, të ligjshme dhe etike në sistemet tona shkollore, si dhe në aspektin shoqëror dhe atë profesional. Duket se një strategji e qartë

për të mbrojtur nxënësit tanë është duke i bërë ata më të përgjegjshëm, me qëllim që të bëhen qytetarë digjitalë.

Është e vështirë të imagjinohet se si do të kishim funksionuar pa smartfonët, laptopët dhe shërbimet me të cilat kemi akses në internet. Ato janë një pjesë thelbësore e jetës sonë personale dhe profesionale.

Çfarë është siguria kibernetike?

Siguria kibernetike i referohet mënyrës se si individët dhe organizatat:

- Mbrojnë pajisjet, shërbimet dhe rrjetet nga vjedhjet dhe dëmtimet.
- Parandalojnë hyrjen e paautorizuar në informacionin personal të ruajtur në pajisje dhe në llogari.

Është e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm për hapat që mund të ndërmarrim për të mbrojtur pajisjet dhe për të parandaluar aksesin ose humbjen e paautorizuar, si dhe duke ndihmuar fëmijët dhe të rinjtë të bëjnë edhe këtë.

Informacioni personal mund të përfshijë:

- një emër;
- një adresë shtëpie;
- një adresë email;
- të dhënat e vendndodhjes.

Kujdesuni për sigurinë kibernetike me pajisjet dhe llogaritë në internet që përdorni duke ndërmarrë këto gjashtë hapa të botuar nga Cyber Aëare:

Përmirësoni sigurinë e fjalëkalimit tuaj

1. *Krijoni një fjalëkalim të veçantë për email-in tuaj.*

Llogaria juaj e postës elektronike është porta hyrëse për të gjitha llogaritë tuaja të tjera në internet dhe përmban shumë informacione të rëndësishme për ju. Përdorni një fjalëkalim të fortë që është i ndryshëm nga të gjithë të tjerët.

2. *Krijoni fjalëkalime të vështira dhe të paharrueshme duke përdorur tre fjalë të rastit.*

Krijoni fjalëkalime të vështira dhe të paharrueshme duke përdorur tre fjalë të rastit që do të thonë diçka për ju, për shembull YlberAnanasQentë.

3. *Ruani fjalëkalimet tuaja në browser-in tuaj.*

Përdorimi i të njëjtave fjalëkalime për të gjitha llogaritë tuaja ju bën të pambrojtur - nëse vidhet ai fjalëkalim, të gjitha llogaritë tuaja mund të jenë të rrezikuara. Sigurisht, të mbash mend shumë fjalëkalime mund të jetë e vështirë, por ju mund t'i ruani në broëser-in tuaj.

Shtoni mbrojtje shtesë

4. *Përdorni vërtetimin me dy faktorë në llogaritë tuaja.*

Vërtetimi me dy faktorë është një tipar sigurie falas që zvogëlon rrezikun e vjedhjeve duke ju kërkuar që të siguronit një faktor të dytë informacioni, siç është marrja e një teksti ose kodi kur hyni.

5. *Mbajeni pajisjen tuaj të përditësuar (update)*

Përdorimi i versioneve më të fundit të softuerit (përfshirë programin anti-virus), aplikacionet dhe sistemi operativ në pajisjen tuaj mund të përmirësojnë menjëherë sigurinë.

Sigurohuni që të mund të recuperoni shpejt

6. *Aktivizoni rezervimin*

Aktivizoni rezervimin për t'u siguruar që keni një kopje të të gjithë informacionit tuaj të rëndësishëm në rast të humbjes, dëmtimit ose vjedhjes së tij. Këto hapa zbatohen për pajisjet personale dhe llogaritë dhe ato që përdorni në punë.

5 METODOLOGJIA DHE TIK-U NË PROCESIN MËSIMOR

5.1 Ndikimi i TIK-ut në përmirësimin e metodave të mësimdhënies - nxënies

Përdorimi i TIK-ut në procesin mësimor ka ndikuar fuqishëm në përmirësimin e metodave të mësimdhënies - nxënies. Fokusi kryesor i këtij Manuali është përdorimi i TIK-ut në klasë, në të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar, në të gjitha shkollat e vendit, duke ofruar një qasje të re si për metodën e mësimdhënies nga mësuesit, ashtu edhe për mënyrën e nxënies nga nxënësit.


Krahas metodave tradicionale të mësimdhënies, si shpjegimi, përdorimi i dërrasës së zezë, apo i mjeteve didaktike fizike, si trupa, figura, skema demonstrimesh apo eksperimentesh, etj., sot po shfrytëzohen mundësitë e shumta që ofron kompjuteri dhe interneti, për t'í pasuruar shumë këto metoda dhe për ta bërë mësimin sa më interaktiv dhe tërheqës për nxënësin.

Duke studiuar eksperiencat bashkëkohore, mund t'í grupojmë këto metoda të bazuara në përdorimin e TIK-ut, në tri kategori sipas metodologjisë dhe teknologjisë informatike që ato përdorin:

- a) Filmime, video, animime, etj. ku folësi shpjegon apo demonstroi një mësim, një dukuri, apo një çështje nëpërmjet vizualizimeve të filmuara apo të animuara. Këto filmime, video, etj, mund të shkarkohen nga interneti apo mund të ekzekutohen direkt nga interneti (shih psh . “YouTube”), nëpërmjet çdo program (aplikimi) si Windows Media Player, apo aplikime të ngjashme me të. Përgjithësisht ato janë në gjuhë të huaj, ndaj ndonjëherë, përdorimi i tyre nga mësuesit paraqet vështirësi.
- b) Sekuenca animimesh, videosh, figurash, etj, që janë përgatitur në formën e një skedari kompakt (zakonisht në formatin shockwave:.swf), i cili ekzekutohet nga shfletuesit (Browser) e Internetit si Firefox, Internet Explorer, Moxilla, etj. Por, këta shfletues duhet

të jenë pajisur me plug-in (shtojcë), që shkarkohet falas nga internet dhe instalohen lehtësisht, siç janë Adobe Flash Player ose Quick Time.

- c) Java Applet – Kjo teknologji është më e përhapura në mësimdhënie, sepse përdoruesi është gjithnjë në bashkëveprim me aplikimin. Java applet-e janë programe të shkruara në një gjuhë programimi që quhet Java dhe që janë shkruar enkas për të vizualizuar një dukuri, një eksperiment apo një mësim. Programi burim, zakonisht nuk jepet në internet. Por në internet hidhet programi i kompiluar në formën e një skedari i emërtuar .class, i cili mund të ekzekutohet nga shfletuesit e Internetit nëpërmjet komandave që njeh gjuha HTML e shkrimit të faqeve .htm apo .html. Zakonisht në këto faqe html shkruhet edhe teksti i mësimit, apo udhëzimi si përdoret appleti. Shpesh kur janë disa klasa (programe të kompiluara) dhe disa skedarë, ato zipohen në formën e një skedari të vetëm të lloit .jar, i cili njihet dhe ekzekutohet nga komanda të gjuhës htm nga shfletuesit e internetit. Përdorimi i tyre është i thjeshtë, por shfletuesi që përdoret duhet të jetë i pajisur me një shtojcë JSE, e cila shkarkohet falas nga interneti (Java (TM) Web Start) dhe instalohet thjeshtë duke ekzekutuar skedarin e shkarkuar.



5.2 Përdorimi efektiv i TIK-ut në procesin e mësimdhënie - nxënies

Për të siguruar përdorimin efektiv të TIK-ut mësuesi duhet :

- 📁 të planifikojë përdorimin e TIK-ut nga ana e nxënësve në bashkëpunim me departamentin e TIK, për të siguruar që nxënësit të kenë aftësitë e duhura të TIK-ut;
- 📁 të planifikojë temat, për të cilat mund të përdoret TIK-u;
- 📁 të jetë i sigurt se burimet e TIK-ut janë në dispozicion për mësimdhënie–nxënien.

Përdorimin e TIK-ut si mjet në orën e mësimi mund ta shohim në disa raste siç po i përshkruajmë më poshtë:

Një orë mësimi në laboratorin e kompjuterave

Në një laborator kompjuterash ku mësimi zhvillohet me ndihmën e teknologjisë, nxënësit rrinë para kompjuterave dhe zhvillojnë veprimtaritë e tyre individuale si: përdorimi i programeve të ndryshme, kërkimi në internet, shkrimi i letrave dhe dërgimi i tyre elektronikisht, punime apo detyra individuale apo bashkëpunim online mes nxënësish. Nëpërmjet kësaj metode realizohet mësimi individual si dhe komunikimi online.

Një orë mësimi në një klasë me disa kompjutera

Në klasat me disa kompjutera mund të kryhen disa veprimtari. Në këto lloj klasash të organizuara në grupe me nga tre- katër nxënës komunikimi mësues-nxënës realizohet më lirshëm mes tyre. Ndryshe nga laboratori, nxënësit kanë mundësi të punojnë pa kompjuterin dhe të përdorin atë vetëm kur u duhet ose nëse u duhet. Në këtë mjedis teknologjia shërben si mjet për të zgjidhur të gjitha llojet e detyrave që nga krijimi i faqeve të internetit deri në krijimin e portofoleve personale. Në këto klasa mësuesit mund t'u japin nxënësve detyra të cilat bëhen me ndihmën e kompjuterit, duke bashkëpunuar me shokët e klasës ose nëpërmjet shkëmbimeve online.

Një orë mësimi në klasa me një kompjuter

Në disa shkolla, disa klasa janë pajisur me nga një kompjuter. Edhe pse një kompjuter mund të duket i pamjaftueshëm, zhvillimi i mësimi me një kompjuter ka disa përparësi:

- Mësuesi menaxhon veprimtarinë e nxënësve në çdo moment.
- Mësuesi kontrollon lehtësisht veprimtarinë e nxënësve duke i udhëzuar ato.
- Teknologjia është në dispozicion në momentin e duhur.
- Nxënësit mund të shohin njëri-tjetrin dhe të bashkëpunojnë lirshëm.
- Duke pasur vetëm një kompjuter në klasë, vëmendja zhvendoset nga teknologjia në mësim nëpërmjet bashkëpunimit.

Përdorimi i TIK-ut në mësim rrit cilësinë e mësimdhënies, paraqet një strategji mjaft të rëndësishme për asimilimin e njohurive dhe ofron mundësi për përmirësimin e sistemit arsimor. Për këtë arsye, rekomandohet aplikimi i metodave të reja të mësimdhënies dhe nxënies duke integruar TIK-un në proces vetëm në orët kur shikohet e arsyeshme. Për të realizuar orë të tilla nevojiten këto pajisje:

- Kompjutera;
- Printer
- Videoprojektor;
- Rrjete kompjuterike lokale;
- Instalim internet;

- Softëere për të gjitha lëndët;
- Laboratorë virtual....etj

5.3 Zhvendosja e qasjes së mësuesit dhe nxënësit në procesin e mësimdhënie - nxënies

Specialistë të arsimit theksojnë se si qasjet e mësuesve në klasa po ndryshojnë si rezultat i zbatimit të TIK-ut në orën mësimore. Nëpërmjet tabelës më poshtë po japim një shpjegim se si qasja mësuesit ndaj orës mësimore ku TIK-u përdoret si metodologji zhvendoset nga një pozicion në një tjetër⁹:

Ndryshimet në qasjen e mësuesit	
Një zhvendosje nga	Në
Mësuesi si transmetues i njohurive të gatshme.	Mësuesi në rolin e trajnerit , i cili udhëheq, drejton, vlerëson nxënësin për të arritur vetë në gjetjen e informacionit.
Mësuesi si burim kryesor i informacionit në klasë.	Mësuesi si drejtues dhe bashkëpunëtor në proces.
Mësuesi kontrollon dhe drejton të gjitha aspektet në orën e mësimi.	Mësuesi i jep nxënësve shumë opsione, por i rrit përgjegjësitë atyre për të zgjedhur vetë opsionin e tyre.

Ndryshimi i qasjes të mësuesve është zhvendosur nga aktor kryesor i orës në të gjitha aspektet në menaxher dhe drejtues i procesit. Mësuesi nuk është më aktori i vetëm kryesor i procesit mësimor, por roli i tij në këtë proces krahasohet me atë të një trajneri ekipi ose të një dirigjenti orkestre që me udhëzimet që jep arrin performancën më të mirë të të gjithë lojtarëve. Meqenëse rolet e mësuesve kanë ndryshuar si rezultat i përdorimit të TIK-ut, po ashtu kanë ndryshuar edhe rolet e nxënësve në orën mësimore.

Ndryshimet në qasjen e nxënësit	
Një zhvendosje nga	Në
Pjesëmarrës pasiv në procesin mësimor.	Pjesëmarrës aktiv në procesin mësimor.
Riprodhues i njohurive.	Prodhon ide.
Mësimnxënie në mënyrë individuale.	Mësimnxënie në bashkëpunim me të tjerët.
Nxënësi me varësi intelektuale nga mësuesi.	Nxënësi me liri intelektuale nga mësuesi.

⁹ICT Frame work, Unesco, 2018,

Nxënësit në klasat ku TIK-u përdoret rregullisht marrin pjesë aktive në mësim, janë hulumtues, kërkojnë në website informacione për të bërë projekte individuale ose në grup, komunikojnë përmes emailit ose rrjeteve sociale me nxënësit e shkollave të tjera dhe arrijnë konkluzione në bazë të të dhënave të mbledhura.

Në nivel institucional drejtuesit e shkollave e kanë domosdoshmëri përdorimin e TIK-ut për të kryer shumë veprimtari, si: hedhjen e të dhënave për secilin mësues dhe secilin nxënës, inventarizime, komunikim me DAR/ZA-të, Ministrinë, institucionet arsimore, shkollat e tjera me stafin apo prindërit, përgatitjen e dokumenteve, përgatitjen e testeve, mbajtja e dokumentacionit shkollor dhe printimin të tyre. Shkollat përdorin software të specializuara për detyra si oraret mësimore të klasave, raportime elektronike, evidentimi i rezultateve dhe frekuentimi i nxënësve, si dhe menaxhimi i bibliotekës së shkollës. Në formën e një projekti me ndihmën e nxënësve të talentuar dhe të mësuesve të informatikës shkolla mund të krijojnë vetë një faqe internet ose një bibliotekë online.

6. VEPRIMTARIP PËR TRAJNIMIN E MËSUESVE NË PËRDORIMIN E TIK-ut NË PROCESIN E MËSIMDHËNIE – NXËNIES

Në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve të TIK-ut për përdorimin e kompetencës digjitale në procesin mësimor, ASCAP në bashkëpunim me UNICEF-in në Shqipëri dhe me mbështetjen e SDF Fund nëpërmjet financimit të qeverisë holandeze, kanë hartuar programin e trajnimit **“Përdorimi i TIK në procesin e mësimdhënie – nxënies”**. Ky program përmban 6 module trajnimi si dhe fletë pune të organizuara si më poshtë:

-  *Zbatimi i standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut.*
-  *Kompjuteri dhe lundrimi në internet.*
-  *TIK dhe mësimdhënia/nxënia.*
-  *Përdorimi i TIK-ut në zbatimin e kurrikulës dhe në vlerësimin e nxënësit.*
-  *Përdorimi i platformave online në procesin mësimor.*
-  *Qytetaria digjitale dhe siguria në internet në mjediset digjitale.*

Veprimtaritë e paraqitura më poshtë janë hartuar në kuadër të moduleve të trajnimit të cilat janë akredituar nga Komisioni i Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit.


Veprimtaria 1 Vetëvlerësimi i nevojave për zhvillim profesional të mësuesit bazuar në standardet e TIK

Qëllimi: Me anë të kësaj veprimtarie mësuesi shqyrton në mënyrë individuale përmbushjen e përgjegjësiave për arritjet e nxënësve si dhe për të kuptuar në kohë pikat e tij të forta dhe ato të dobëta.

Hapat për realizimin e veprimtarisë:

- Trajneri ka përgatitur një fletë pune për standardin “Zbatimi i aftësive digjitale”.
- Në fletën e punës janë paraqitur treguesit e përmbushjes për këtë standard.
- Pjesëmarrësit punojnë në dyshe (në varësi të kushteve specifike) dhe plotësojnë *hartën e mendjes* lidhur me përmbushjen e këtyre treguesve apo me nevoja të mëtejshme për zhvillim.

Harta e mendjes



Në qendër të hartës vendoset standardi, degët janë treguesit dhe më pas degët (treguesit) zbërthehen edhe më tej me nevojat për përmbushjen e treguesit përkatës

Në këtë mënyrë mësuesi mund të vlerësojë veten për një bllok treguesish, për një standard, ose mund të bëjë një vlerësim tërësor të të gjithë treguesve. Vlerësimi i standardeve bazohet në fakte, prova, evidenca si dhe në veprimtari konkrete që mësuesi realizon në klasë gjatë procesit mësimor

Standardi “Zbatimi i aftësive digjitale” dhe disa tregues të tij

Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron njohuri dhe aftësi të përdorimit të TIK-ut dhe mjeteve digjitale, të tilla si kompjuter, pajisje mobile, programe kompjuterike, aplikacione, postë elektronike, platforma online, rrjete sociale etj., për qëllime mësimore. Mësuesi siguron akses dhe “përdorim të sigurt” të këtyre mjeteve digjitale për të gjithë nxënësit. Ai përzgjedh mjete dhe burime të

ndryshme digjitale për të krijuar një mjedis të integruar të nxëni, si dhe për të zhvilluar te nxënësit aftësitë e të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemit. Mësuesi përdor mjetet digjitale për të mbështetur të mësuarit gjithëpërfshirës.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit Mësuesi:	Niveli (shembull)
<i>kupton dhe demonstroi përdorimin e mjeteve digjitale për qëllime mësimore</i>	2
<i>krijon dokumente dhe prezantime të thjeshta;</i>	3
<i>kupton parimet themelore të sigurisë kibernetike, edukimit mediatik dhe informativ;</i>	2
<i>përdor software për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënësit;</i>	
<i>identifikon dhe vlerëson burime të ëeb-it se sa ato përputhen me qëllimet dhe standardet e kurrikulës dhe nevojat e nxënësve;</i>	
<i>përdor paketa software që janë të përshtatshme për lëndën, për të zhvilluar te nxënësit aftësitë e të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemit;</i>	

Veprimtaria 2: Terminologjia bazë për kompjuterin

Qëllimi: Me anë të kësaj veprimtarie mësuesi identifikon terminologjinë bazë për përdorimin e kompjuterit.

Hapat për realizimin e veprimtarisë:

- Trajneri ka përgatitur një fletë pune “*Terminologjia bazë për kompjuterin*” në të cilin janë përcaktuar termat kryesorë për njohjen e kompjuterit.
- Pjesëmarrësit ndahen në dy grupe:
 - o grupi 1 shkruan cilat janë ato pjesë të kompjuterit që i njohin duke i treguar edhe me dorë,
 - o grupi 2 shkruan ato pjesë kompjuteri që i shohin në fletën e punës , por nuk i njohin.
- Trajneri ju shpjegon pjesëmarrësve rëndësinë e çdo pjese të kompjuterit dhe pjesëmarrësit plotësojnë të gjithë në fletën e punës.



Një pajisje hyrëse harduer që përdoret për të hedhur të dhëna në sistemin kompjuterik.





Një objekt në Sistemin Operativ Ëindoës (OS) nga i cili mund të aksesoni të gjithë programet e instaluara



Një shkurtores e tastierës që përdoret për të kopjuar të dhënat në kujtesën e kompjuterit në një program



Pajisje hyrëse që përdoret për të lexuar kompakt disqet



Një pajisje hyrëse që përdoret për të kapur tingujt për përdorim në kompjuter



Pajisje dalëse harduer që përdoret për të shfaqur tekst dhe imazhe



Një tast që përdoret për të ekzekutuar një komandë ose për të kaluar në rreshtin tjetër në një paketë softueri të përpunuesit të tekstit



Një kopje e printuar e një dokumenti të gjeneruar në kompjuter



Një shkurtore e tastierës që përdoret për të hedhur të dhënat e kopjuara nga kujtesa e kompjuterit në një program



Një pajisje ruajtjeje që nuk ka pjesë lëvizëse dhe që përdoret gjerësisht si një USB



Kabllo e nevojshme për të siguruar energji elektrike për kompjuterin



Buton që përdoret për të aktivizuar kompjuterin nga të qëndruarit pushim



Kabllo e nevojshme për të lidhur ekranin me kompjuterin



Pajisje dalëse që përdoret për të krijuar kopje fizike



Një pajisje që përdoret për të treguar pozicione në ekran



Një pajisje që përdoret për të nxjerrë tinguj



Një pajisje hyrëse që prodhon kopje digjitale të dokumenteve në letër



Mjedisi i punës së një programi. Mënyra se si është projektuar një program për të nxitur përdorimin.



Kompjuteri kryesor që koordinon të gjithë kompjuterat në një rrjet për të punuar së bashku dhe për të ndarë burimet

Veprimtaria 3: Mjetet e TIK-ut që shërbejnë për të përmirësuar procesin mësimor

Qëllimi: Mësuesit identifikojnë avantazhet që sjell përdorimi i mjeteve të TIK-ut në procesin mësimor.

Hapat për realizimin e veprimtarisë:

- Trajneri ka përgatitur fletën e punës “Mjetet e TIK-ut që shërbejnë për të përmirësuar procesin mësimor” dhe ndan në grupe të vogla pjesëmarrësit.
- Secili grup plotëson në fletën e punës së mëposhtme, avantazhet që sjellin mjetet e TIK-ut në procesin mësimor.
- Grupet prezantojnë dhe trajneri moderon diskutimin me të gjithë pjesëmarrësit.

Mjeti teknologjik	Avantazhe
Hardueri	
Projektori i të dhënave/SmartBoard	Shembull: → Lejon jo vetëm shënime për mësimin, të projektuara në një sipërfaqe të madhe në mur, por edhe shfaqjen e përmbajtjes së web-it direkt nga interneti. Diçka e tillë do t’i mundësojë mësuesit të tregojë shembuj konkretë nga bota reale për temën mësimore. Për shembull, në një orë mësimore gjeometrie për trekëndëshat mund të përdoren imazhe të ndërtimit të urave, ku përdoret kjo formë. → Mundëson ndarje e materialeve plotësuese, e cila është e thjeshtë kur projektohen në një sipërfaqe të madhe për t’u parë nga të gjithë. → Mund të përdoret edhe për të projektuar slajdet e Powerpoint-it të parapërgatitura nga mësuesi (tekst, pamje dhe tinguj) për klasën.
MP3 Player/iPod	
Telefoni inteligjent	
Softueri	
Paketa e prezantimit (Powerpoint)	
Paketa grafike (Photoshop ose Paint)	
Përpunuesi i tekstit - Word Processor (MS	Shembull:

Word, Open Office Writer)	→ Është mjet thelbësor për të përgatitur në mënyrë të qartë dhe profesionale plane mësimore, teste, materiale ndihmëse, shënime për klasën, fleta pune etj. → Eliminon problemin e lexueshmërisë së shkrimit të dorës. → Kontrollon drejtshkrimin dhe gramatikën dhe është shumë i thjeshtë në përdorim. → Materialet mund të printohen ose shpërndahen në mënyrë elektronike, që është me kosto më efikase. → Lejon futjen e imazheve dhe figurave (clip art).
Editues videosh (Video Editor) (Movie Maker)	

Veprimtaria 4: Si mund të përdoret kompjuteri në klasë?

Qëllimi: Mësuesit japin shembuj të përdorimit të kompjuterit në klasë

Hapat për realizimin e veprimtarisë:

- Trajneri prezanton disa udhëzime për mësuesit në lidhje me përdorimin e kompjuterit. Ai ka përgatitur fletën e punës “Si mund të përdoret kompjuteri në klasë?”. në një kolonë të së cilës janë dhënë udhëzimet për mësuesit në lidhje me përdorimin e kompjuterit.
- Pjesëmarrësit ndahen në tri grupe.
- Grupi i parë jep shembuj për secilin udhëzim, në rast se në klasë ka vetëm një kompjuter.
- Grupi i dytë jep shembuj për secilin udhëzim, në rast se në klasë ka disa kompjuter.
- Grupi i tretë jep shembuj për secilin udhëzim, pavarësisht nga numri i kompjuterëve.
- Grupet prezantojnë dhe trajneri moderon diskutimin me të gjithë pjesëmarrësit.

Udhëzime	Shembuj
Nëse keni vetëm një kompjuter në klasë	
Siguroni akses të përshtatshëm.	Shembull: - Vendoset kompjuteri në një pozicion të dukshëm për të gjithë nxënësit.
Krijoni “ekspertë të stërvitur” për t’ju ndihmuar.	→ ...
Hartoni sisteme për përdorimin e kompjuterit.	→ ...
Nëse keni më shumë se një kompjuter në klasë	

Planifikoni sistemimin e kompjuterëve në përshtatje me qëllimet tuaja mësimore.	Shembull: → Sistemohen nxënësit në mënyrë të atillë që të vendosen përpara kompjuterit të grupit të tyre.
Eksperimentoni me modele të tjera të përdorimit të kompjuterit.	Shembull: → Modeli me moderator: Vendosen 6 nxënës për kompjuter dhe një moderator. Moderatorin ka më shumë njohuri dhe aftësi në përdorimin e kompjuterit dhe shërben si udhëzues ose si mentor për nxënësit e tjerë.
Pavarësisht nga numri i kompjuterëve që keni në klasë	
Përzgjidhni programe zhvillimore të përshtatshme që nxitin të nxënit, krijueshmërinë dhe ndërveprimin shoqëror të nxënësve.	→ ...
Mbikëqyrni nxënësit kur punojnë në kompjuter.	→ ...
Kujdeseni për sigurinë e nxënësve gjatë punës së tyre në kompjuter.	Shembull: → Mësohen nxënësit ta mbrojnë identitetin e tyre në internet dhe mbikëqyret çdo mik me të cilin mund të komunikojnë.

Veprimtaria 5: Krijimi, redaktimi, formatimi dhe printimi i një dokumenti në Word

Qëllimi: Aftësimi i mësuesve për të përdorur programin Word

Hapat për realizimin e veprimtarisë:

→ Trajneri prezanton disa udhëzime për pjesëmarrësit në lidhje me shkrimin e një kërkesë: *Kur shkruani një letër që kërkon një përgjigje ose një informacion, paragrafi i parë duhet të prezantojë autorin dhe të shpjegojë qëllimin e letrës. Paragrafi i dytë duhet të shpjegojë çdo detaj të nevojshëm të kërkesës dhe të bëjë pyetje të tjera. Paragrafi i tretë duhet të falënderojë lexuesin për shqyrtimin e tij dhe të theksojë kërkesën.*

→ Trajneri ka përgatitur një model kërkesë (shihni më poshtë) dhe u paraqet pjesëmarrësve.

a) *Kërkesë*

E nderuara Znj. Valbona:

Jam regjistruar në kursin e kuzhinës që po jepni këtë pranverë. Unë nuk kam shumë përvojë në gatimet tradicionale, por e kam admiruar punën tuaj si kuzhinieri për shumë vite. Jam e nderuar dhe e emocionuar që marr pjesë në kursin tuaj.

Edhe mikesha ime donte të regjistrohej në kursin tuaj të kuzhinës. Nëse ka akoma vende të lira, ajo dëshiron të jetë në të njëjtin grup në të cilin jam regjistruar edhe unë. Ju lutem, më dërgoni një broshurë dhe informacionin e disponueshëm në adresën time të emailit: bujarigenta@gmail.com

Jam e vetëdijshme që vendet në grupet tuaja zihen shpejt. Mikesha ime po pret me padurim përgjigjen tuaj, në mënyrë që të regjistrohet. Faleminderit shumë për kohën tuaj

Sinqerisht,
Genta Bujari

→ Trajneri paraqet kërkesat për pjesëmarrësit, të cilin punojnë në mënyrë të pavarur (ose në çift në varësi të kushteve specifike):

- Hapni një dokument në word shkruajeni modelin e kërkesës.
- Kontrolloni tekstin në ekran dhe korrigjoni gabimet dhe gabimet drejtshkrimore. Hiqni vijën e kuqe të valëzuar nga fjalët e shkruara mirë.
- Ruani dokumentin me emërtimin *Kërkesë* dhe printoni një kopje.
- Bëni ndryshimet e mëposhtme në letër:
 - Ndryshoni fjalën **admiruar** me **pëlqyer** në fjalinë e dytë.
 - Ndryshoni fjalët **një broshurë** në **një aplikim** në paragrafin e dytë.
 - Përdorni fjalorin sinonimik për të ndryshuar fjalën **shpejt** në paragrafin e katërt me një sinonim të përshtatshëm.
 - Ndryshoni Genta Bujari me emrin tuaj.

b) *Letër*

→ Trajneri ka përgatitur një model letre (shihni më poshtë) dhe u paraqet pjesëmarrësve.

E nderuara znj. Elira,

Po shkruaj për t'ju falënderuar për donacionin tuaj shumë bujar në bibliotekën e shkollës sonë. Ne jemi gjithmonë mirënjohës ndaj dhurimeve, si monetare ashtu edhe të tjera.

Siç jeni dhe ju në dijeni, biblioteka jonë kishte nevojë për libra të rinj prej disa vitesh tashmë. Nxënësit e shkollës sonë kërkonin vazhdimisht libra të rinj për të lexuar. Librat e rinj jo vetëm që do të përdoren për orët mësimore, por edhe për leximet jashtë klase nga nxënësit.

Faleminderit sërish nga zemra!
Sinqerisht,
Albana
Mësuesia e bibliotekës

- Trajneri paraqet kërkesat për pjesëmarrësit, të cilin punojnë në mënyrë të pavarur (ose në çift ose në varësi të kushteve specifike):
- Hapni një dokument në word shkruajeni modelin e letrës.
 - Kontrolloni tekstin në ekran dhe korrigjoni gabimet dhe gabimet drejtshkrimore. Hiqni vijën e kuqe të valëzuar nga fjalët e shkruara mirë.
 - Ruani letrën me emërtimin *Falënderim për dhurimin*
 - Bëni ndryshimet vijuese:
 - Fshini fjalën *shumë* në fjalinë e parë.
 - Përdorni fjalorin sinonimik për të ndryshuar fjalën **mirënjohës** në paragrafin e parë me një sinonim të përshtatshëm.
 - Shtoni fjalinë e mëposhtme në fund të paragrafit të parë në zhvillimin e letrës: Donacioni juaj ishte me të vërtetë një surprizë e mirëpritur.
 - Fshini fjalinë: Nxënësit e shkollës sonë kërkonin vazhdimisht libra të rinj për të lexuar.
- Ndryshoni Albana me emrin tuaj.
- Ruani dokumentin **Falënderime për Donacionin** të modifikuar dhe printoni një kopje.

Veprimtaria 6 : Avantazhet dhe disavantazhet e programit *Power Point*

Qëllimi: Aftësimi i mësuesve për të përdorur programin *Power Point*

Hapat për realizimin e veprimtarisë:

- Trajneri ka përgatitur fletën e punës “Avantazhet dhe disavantazhet e programit *Power Point*” dhe ndan në grupe pjesëmarrësit.
- Secili grup plotëson në fletën e punës së mëposhtme.
- Në fletën e punës, pjesëmarrësit shënojnë avantazhet që duhen shfrytëzuar nga PPT dhe disavantazhet që duhen shmangur gjatë përdorimit të PPT.
- Secili grup prezanton punën e tij dhe në fund bëhen konkluzionet nga trajneri.

Avantazhet që duhen shfrytëzuar në PPT	Disavantazhet që duhen shmangur në PPT
Shembull: Paraqitja e përmbajtjes në Powerpoint e bën më të lehtë strukturimin e një prezantimi.	Shembull: Paraqitja e <i>slide</i> -ve të mbingarkuara me tekst: Nëse përfshihen detaje të tepërta në slide, nxënësit e kanë të vështirë për t'i lexuar, prandaj duhen shmangur.

Detyrë për pjesëmarrësit: Përgatitja e një prezantimi PPT në lëndën përkatëse.

Veprimtaria 7 Vlerësimi i mjeteteve online të TIK-ut për vlerësimin e nxënësve në klasë.

Qëllimi: Mësuesit identifikojnë avantazhet që sjell përdorimi i mjeteve të TIK-ut për vlerësimin e nxënësve në klasë.

Hapat për realizimin e veprimtarisë:

- Trajneri ka përgatitur fletën e punës “Vlerësimi i Mjeteve Online të TIK-ut për vlerësimin e nxënësve” .
- Trajneri ndan në çifte pjesëmarrësit.
- Trajneri i kërkon secilit pjesëmarrës të hapë adresën e tij të emailit si kërkesë për t’u regjistruar në platformat online: Quiz Star; Survey Monkey; Quandary.
- Trajneri i kërkon çdo çifti të praktikojë për rreth 30 minuta mjetet e TIK-ut më poshtë:
 - 🚦 Quiz Star: <http://quizstar.4teachers.org/> (mjet online pa pagesë)
 - 🚦 Survey Monkey: <http://www.surveymonkey.com/> (mjet online pa pagesë)
 - 🚦 Quandary: <http://www.halfbakedsoftware.com/quandary.php> (mjet online pa pagesë).
- Trajneri i kërkon çdo çifti të plotësojë fletën e punës.
- Secili çift pasi ka praktikuar secilin nga mjete e mësipërme plotëson në fletën e punës së mëposhtme, zgjedhjet dhe preferencat e tij, avantazhet dhe disavantazhet e secilës platformë.
- Grupet prezantojnë dhe trajneri moderon diskutimin me të gjithë pjesëmarrësit.

Emri i mjetit	Lehtësia në përdorim (5 = Shumë i vështirë)	Lloji më i mirë për vlerësimin? (Theksoni zgjedhjen)	Mënyra e vlerësimit (Theksoni të saktën)
Quiz Star	1 2 3 4 5	Përmbledhës Formues	Zgjedhjet e përdoruesit Preferencat Me zgjedhje të shumëfishtë Shkak-pasojë Skenarët

- Formuloni një gjykim të këtij shërbimi vlerësues duke përshkruar përshtypjet tuaja të përgjithshme (p.sh., të qenit miqësor me përdoruesin, sofistikimi, dobishmëria, etj.) - Diskutoni se në çfarë rrethanash mund ta përdorni këtë mjet për të mbështetur strategjinë e vlerësimit në fushën tuaj lëndore/të të nxënit. Jepni shembuj praktikë.			
Survey Monkey	1 2 3 4 5	Përmbledhës Formues	Zgjedhjet e përdoruesit Preferencat Me zgjedhje të shumëfishtë Shkak-pasojë Skenarët
- Formuloni një gjykim të këtij shërbimi vlerësues duke përshkruar përshtypjet tuaja të përgjithshme (p.sh., të qenit miqësor me përdoruesin, sofistikimi, dobishmëria, etj.) - Diskutoni se në çfarë rrethanash mund ta përdorni këtë mjet për të mbështetur strategjinë e vlerësimit në fushën tuaj lëndore/të të nxënit. Jepni shembuj praktikë.			
Quandary	1 2 3 4 5	Përmbledhës Formues	Zgjedhjet e përdoruesit Preferencat Me zgjedhje të shumëfishtë Shkak-pasojë Skenarët
- Formuloni një gjykim të këtij shërbimi vlerësues duke përshkruar përshtypjet tuaja të përgjithshme (p.sh., të qenit miqësor me përdoruesin, sofistikimi, dobishmëria, etj.) - Diskutoni se në çfarë rrethanash mund ta përdorni këtë mjet për të mbështetur strategjinë e vlerësimit në fushën tuaj lëndore/të të nxënit. Jepni shembuj praktikë.			

Veprimtaria 8 Vlerësimi i platformës moodle

Qëllimi: Me anë të kësaj veprimtarie mësuesi identifikon hapat e përdorimit të platformës Moodle si një sistem i tërë për vlerësimin e performancës së nxënësve, si dhe gjykon mbi rëndësinë që mund të ketë instalimi i një sistem të tillë në shkollë.

Hapat për realizimin e veprimtarisë:

Praktikë kompjuterike për përdorimin e platformës moodle

- Trajneri ka përgatitur një fletë pune tutorial për hapat e përdorimit të platformës *moodle*.
- Mësuesit punojnë në dyshe në një mjedis me pajisje digjitale (kompjuter, laptop, tablet etj.).
- Trajneri prezanton faqen zyrtare të web-it ku mësuesit mund të shkarkojnë platformën. Këto mjete janë të përshtatshme për vlerësimin e nxënësve gjatë vlerësimit formues. Një sistem i tillë që do të duhej të instalohet në serverin e shkollës suaj dhe në të cilin ju mund të mbështetnit vlerësimin formues të nxënësve tuaj në mënyrë elektronike është **Moodle**.
- Trajneri prezanton hapat e shkarkimit dhe përdorimit të platformës Moodle gjatë procesit mësimor. Kjo platformë është një sistem i tërë vlerësimi e cila ka një hapësirë të madhe për kuize dhe për të ndjekur performancën e nxënësit.
- Për secilin rubrikë të platformës moodle pjesëmarrësit sjellin komentet e tyre dhe diskutojnë.
- Pas përdorimit të kësaj platforme pjesëmarrësit diskutojnë për rolin që mund të ketë një sistem i tillë në shkollë.
- Trajneri moderon diskutimin me të gjithë pjesëmarrësit.

Fletë pune

1. Lundroni në <http://school.demo.moodle.net> dhe shqyrtoni funksionet e platformës Moodle.
2. Hyni duke përdorur emrin e përdoruesit: *mësuesi* dhe fjalëkalimin: *moodle*. Ju keni hyrë me sukses nëse mund të shihni emrin Jeffrey Sanders në këndin e sipërm djathtas.
3. Në kutizën me titull “Kurset e mia”, (my courses) kërkoni kursin “Poetët e Liqeneve” (The Lakes Poets) dhe klikoni për të hyrë.
4. Kursi përqendrohet te poetët WordsWorth, Coleridge dhe Southey. Secili poet ka kutizën e vet . Zbrisni më poshtë dhe eksperimentoni me multimedia të ndryshme.
5. Në kutizën e 4-t të temës me titull “Fundi i Veprimtarive të Kapitullit”, gjendet *Kuizi i Vlerësimit Përmbledhës*. Klikoni tekstin për të hyrë.
6. Klikoni butonin “start” për të filluar testin.

Topic outline

Your progress ?

Terms of the Time

☰

Welcome!

This course forms the introductory module to our studies of the Lake District poets. We will be investigating the general background to the three main poets, Wordsworth, Coleridge and Southey and choosing one poem from each in particular. If you enjoy the course, consider opting for our Romantic Poetry module later in the academic year.



Lakes Forum
 Who are the Lakes Poets?



Kubla Khan

Kubla (or Kublai) Khan was the founder of the Yuan dynasty in China.

Add other terms when you find them
More terms

Where's this?

☰



Attribution, Share Alike. Resources and images are either created by the



- Gjykoni mbi llojet e pyetjeve të përdorura: pyetje me zgjedhje të shumëfishtë dhe ese, “e vërtetë apo e gabuar”, përgjigje të shkurtra, pyetje me përgjigje “po ose jo”, pyetje “lidh me shigjetë”, etj.
- Reflektoni për rolin që mund të ketë një sistem i tillë në shkollën tuaj. Shkruani një paragraf të shkurtër ku të shpjegoni anët pozitive dhe negative të sistemit digjital.

Veprimtaria 9 Përdorimi i platformës Google Forms për ndërtimin e pyetjeve

Qëllimi: Me anë të kësaj veprimtarie mësuesi identifikon hapat e përdorimit të platformës Google forms në vlerësimin e vazhduar të nxënësve nëpërmjet përdorimit të llojeve të ndryshme.

Hapat për realizimin e veprimtarisë:

Trajneri ka përgatitur një fletë pune (tutorial) për hapat e përdorimit të platformës Google Forms në ndërtimin e pyetjeve të llojeve të ndryshme. Mësuesit punojnë individualisht ose në dyshe në një mjedis me pajisje digjitale (kompjuter, laptop, tablet etj.).


Trajneri shtron për diskutim me pjesëmarrësit pyetjet: A e njihni platformën Google Forms? Përse mund të përdoret? A e keni përdorur ndonjëherë?

Trajneri prezanton faqen zyrtare të web-it ku mësuesit mund të shkarkojnë platformën. Ai prezanton hapat e shkarkimit dhe përdorimit të platformës Google Forms për vlerësimin e nxënësve.


Praktikë kompjuterike

Mësuesit përmes përdorimit të kompjuterit/laptopit/tabletës mund të zbatojnë të gjitha hapat e shkimit dhe përdorimit të platformës Google Forms në ndërtimin e pyetjeve, organizimin e quizeve dhe vlerësimin e nxënësve.


Hapim Google dhe klikojmë Google Forms.



Klikojmë faqen kryesore të Google Forms.



Klikojmë “Go to Google Forms”



Vijon.....

Veprimtaria 10: Përdorimi i TIK-ut për kryerjen e detyrave rutinë të mësuesit

Qëllimi: Përmes kësaj veprimtarie mësuesi identifikon disa ndër strategjitë për përdorimin e TIK-ut për planifikimin e mësimdhënies, për vlerësimin e nxënësve dhe për kryerjen e detyrave të tjera rutinë.

Hapat për realizimin e veprimtarisë:

- Trajneri nxit diskutimin rreth detyrave të ndryshme me natyrë planifikuese dhe administrative që mësuesve u duhet të realizojnë dhe rritjes së produktivitetit përmes përdorimit të mjeteve të TIK-ut.
- Pjesëmarrësit ndahen në grupe me nga 3-4 persona. Secilit prej pjesëmarrësve u shpërndahet *fleta e punës “Përdorimi i TIK-ut për kryerjen e detyrave rutinë të mësuesit”*. Fillimisht pjesëmarrësit plotësojnë individualisht fletën e punës dhe më pas brenda grupit diskutojnë rreth saj.
- Për plotësimin e fletës së punës, në kolonën “Qasja përmes përdorimit të TIK-ut”, pjesëmarrësve u kërkohet të identifikojnë mjetin më të përshtatshëm të TIK-ut që mund të përdorin për realizimin e veprimtarive që lidhen me rutinën e tyre të përditshme (si p.sh., word processor për shkrimin/përpunimin e një teksti; programin excel për krijimin/përpunimin e një baze të dhënash; platformën Google Forms ose platforma të tjera për ndërtimin dhe vlerësimin e një testi etj).
- Trajneri porosit pjesëmarrësit që përpara se të përzgjedhin mjetin e duhur, të sigurohen për pikat e forta dhe të dobëta të mjetit/mjeteve që kanë përzgjedhur për kryerjen e rutinave që lidhen me mësimdhënien.
- Pas diskutimit brenda grupit, zhvillohet diskutimi me të gjithë pjesëmarrësit.

Fleta e punës “Përdorimi i TIK-ut për kryerjen e detyrave rutinë të mësuesit

Veprimtaria	Qasja tradicionale	Qasja përmes përdorimit të TIK-ut
<i>Planifikimi</i>	Mësuesi zhvillon planet (planin vjetor, planin e periudhës, planin ditor) në një fletore /bllok shënimesh.	
<i>Mbajtja e shënimeve për vlerësimin e</i>	Mësuesi mban shënime për vlerësimin e vazhduar të	

<i>nxënësve në evidencat</i>	nxënësve në një bllok/fletore shënimesh ose në evidencë (fletë).	
<i>Vlerësimi i nxënësve përmes testit</i>	Mësuesi përgatit testin në formatin e shtypur (në letër) të cilin e korrigjon më pas me dorë.	
<i>Bashkëpunimi për çështje të ndryshme të mësimdhënies</i>	Mësuesit takohen fizikisht për të diskutuar, për të shkëmbyer ide dhe materiale mes tyre.	<i>Shembull:</i> - Mësuesit shkëmbejnë përmes postës elektronike materiale të ndryshme; - nëse materiali që duan të ngarkojnë me email ka ngarkesë, atëherë përdorin google drive/ wetransfer etj., për të ngarkuar materialin; - për të diskutuar dhe prezantuar një çështje/material mund të përdorin një platformë online, si p.sh. Zoom.
<i>Sfidat:</i>		

Veprimtaria 11: Përdorimi i TIK-ut për zhvillimin profesional të mësuesit

Qëllimi: Përmes kësaj veprimtarie mësuesi përcakton disa ndër format e përdorimit të TIK-ut për zhvillimin e tij të vazhduar profesional.

Hapat për realizimin e veprimtarisë:

- Në hyrje të kësaj veprimtarie trajneri nxit diskutimin mbi mësimdhënien si profesion, format dhe rrugët e zhvillimit të vazhduar profesional përmes përdorimit të TIK-ut.
- Pjesëmarrësit të ndarë në grupe shqyrtojnë situatën e paraqitur në fletën e punës “Përdorimi i TIK-ut për të nxënëit gjatë gjithë jetës”. Referuar pyetjeve të parashtruara në fletën e punës, pjesëmarrësit diskutojnë brenda grupit dhe më pas ndërmjet grupeve.
- Trajneri moderon diskutimin dhe bën një përmbledhje të diskutimeve.

Fletë pune “Përdorimi i TIK-ut për të nxënëit gjatë gjithë jetës”

Situatë rasti

Arbeni është mësues i biologjisë në shkollë të mesme. Ai jep mësim prej dy vitesh dhe dëshiron të zgjerojë njohuritë rreth lëndës së tij, në veçanti lidhur me mënyrat novatore për të përdorur teknologjinë në procesin e mësimdhënies. Arbeni është një përdorues mjaft i aftë dhe autodidakt i TIK-ut, si dhe zotëron një sërë aftësish në këtë fushë. Ai është shumë i zënë gjatë pasditeve duke mbikëqyrur veprimtaritë jashtëshkollore, prandaj ai preferon të zgjedhë një rrugë për zhvillimin e tij profesional që ofron më shumë fleksibilitet.

Referojuni studimit të rastit të mësipërm për t’iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:


- 1. Si mund ta përdorë Arbeni TIK-un për të arritur qëllimet e tij të zhvillimit profesional? Cilat forma të zhvillimit profesional online mund të shfrytëzojë ai?*
- 2. Krijoni një matricë duke përcaktuar avantazhet dhe disavantazhet e çdo opsioni që keni identifikuar. Kini parasysh që të bazoheni në informacionin që keni rreth situatës së Arbenit.*
- 3. Më pas, identifikoni një nga tri opsionet që keni përzgjedhur si rekomandimin tuaj përfundimtar. Identifikoni me detaje se çfarë përfshihet në këtë opsion (p.sh., nëse është një trajnim online: Cila është kosto e tij? Është ose jo i akredituar? Cili është niveli i kërkuar i njohurive bazë dhe aksesit në TIK ? etj).*
- 4. Verifikimi i cilësisë dhe vërtetësisë së burimit është një hap tejet i rëndësishëm në rrugën drejt zhvillimit profesional.*

Veprimtaria 12: Siguria në mjediset digjitale

Qëllimi: Përmes kësaj veprimtarie mësuesi identifikon disa ndër rreziqet që shoqërojnë përdorimin e TIK-ut dhe menaxhimin e problematikave që lidhen me to.

Hapat për realizimin e veprimtarisë:

- Pjesëmarrësit ndahen në grupe me nga 3-4 persona.
- Trajneri kërkon që secili prej tyre të identifikojë disa ndër rreziqet kryesore që shoqërojnë përdorimin e mjeteve digjitale (internet-i, platformat e ndryshme, aplikacionet etj), duke i vendosur në hartën e koncepteve.



Pasi prezantojnë hartën e koncepteve, trajneri u shpërndan pjesëmarrësve *fletën e punës* “*Problematika të sigurisë në mjediset digjitale*”.

- në të cilën janë prezantuar dy situata rasti.
- Pjesëmarrësit diskutojnë për këto situata. Ata nxiten të sjellin raste/përvoja të ndryshme në lidhje me këtë çështje.

Fletë pune “Problematika të sigurisë në mjediset digjitale”

Bullizmi në internet ndodh kur fëmijët ngacmojnë njëri-tjetrin përmes teknologjisë si Facebook, Snapchat, Instagram, biseda në grupe, lojëra në internet ose platforma të tjera. Bullizmi përfshin veprime të tilla si kërcënimet, përhapjen e thashethemeve, sulmimin e dikujt fizikisht ose verbalisht, dhe përjashtimin e dikujt nga një grup qëllimisht”. Ngacmimi në internet mund të ndodhë në mënyra të ndryshme, si postimi i vazhdueshëm i komenteve, përhapja e informacionit të rremë për dikë etj.

Situatë rasti 1

Shkolla e mesme “A...” e qytetit X përgjithësisht shquhet për një klimë bashkëpunimi, mirëkuptimi dhe respekti ndërmjet nxënësve, si dhe stafit të mësuesve dhe nxënësve. Nxënësit përgjithësisht e respektojnë njëri-tjetrin. Shkolla ka përcaktuar një politikë antibullizëm. Megjithatë disa nxënës të klasave të 10-ta kanë filluar të krijojnë grupe të cilët ngacmojnë në internet nxënës/nxënëse të shkollës.

Elona, një vajzë nga komuniteti rom dhe nxënëse e klasës së dhjetë, raportoi te drejtori i shkollës se ishte ngacmuar në internet nga disa nxënës. Elona i ka dhënë disa foto të saj njërit prej djemve të klasës së saj. Ai ua ka shpërndarë fotot shokëve të tij dhe djemtë tani kanë filluar të tallen me të dhe ta etiketojnë në rrjetet sociale.

Drejtori, psikologu i shkollës dhe anëtarët e tjerë të stafit pedagogjik nuk kanë reaguar ende por po planifikojnë të diskutojnë incidentin gjatë mbledhjes së mësuesve.

Diskutim rreth situatës:

- Si do të vepronit në një rast të tillë?

- Keni patur raste të tilla në përvojën tuaj ose në përvojat e kolegeve tuaj? Nëse po, si është vepruar?
- Cilat janë rrugët që do të përzgjidhni ju si mësues për trajtimin e situatës?

Situatë rasti 2

Në një bisedë me mësuesen kujdestare, Orioni i tregoi se disa djem të panjohur e kishin ftuar përmes rrjeteve sociale të takoheshin dhe të bëhej pjesë e grupit të tyre. Fillimisht ata ishin miqësorë me Orionin por më pas kishin kërkuar nga djali të takoheshin fizikisht dhe të konsumonin duhan. Orioni nuk kishte pranuar t'i bashkohej këtij grupi dhe për pasojë grupi i djemve kishte filluar të përdorë sharje të ndryshme në rrjetet sociale, madje dhe të shpërndanin lajme të rreme dhe thashetheme në lidhje me Orionin.

Mësuesja pyeti nëse prindërit e tij ishin në dijeni. Orioni u përgjigj "Sigurisht që jo"; ata nuk flasin për këtë në shtëpi, prindërit e tij nuk përdorin media sociale, dhe për këtë arsye ata nuk mund ta kuptojnë situatën.

Diskutim rreth situatës:

- Si do të vepronit në një rast të tillë?
- Keni patur raste të tilla në përvojën tuaj ose në përvojat e kolegeve tuaj? Nëse po, si është vepruar?

7. QYTETARIA DIGJITALE

Çfarë është qytetaria digjitale?¹⁰


"Qytetaria digjitale mund të përkufizohet si një grup normash të sjelljes së duhur dhe të përgjegjshme lidhur me përdorimin e teknologjisë."

Kush quhet qytetar digjital?

Qytetar digjital është kushdo që përdor mjete digjitale si kompjuterë, telefona celularë ose internet në punën e tyre ose në mjedisin shkollor apo për qëllime rekreative. Sikurse qytetarët e një qyteti që duhet të miratojnë rregulla dhe standarde të sjelljes për të jetuar së bashku, ashtu edhe ne duhet të bëjmë të njëjtën gjë në botën digjitale.

¹⁰ http://learntech.ties.k12.mn.us/Digital_Citizenship.html.

Por çfarë duhet të dinë nxënësit tanë për të qenë përdorues të sigurt dhe të sofistikuar të teknologjisë? Çfarë burimesh mund të përdorim për t'i mbështetur? Sipas Andrew Churches, qytetaria ka gjashtë parime:¹¹



Nëntë elementët e qytetarisë digjitale

Elementi i parë është akses i digjital. Përdoruesit e teknologjisë duhet ta dinë që jo çdo person i ka njësoj dyert e hapura në lidhje me inovacionin dhe teknologjinë. Përparimi në drejtim të të drejtave të barabarta dhe mbështetja e aksesit elektronik është faza fillestare e qytetarisë digjitale. Dhënia dhe zgjerimi i aksesit në teknologji duhet të jetë objektivi i çdo kombi.

Elementi i dytë është tregtia digjitale, dhe kjo i referohet blerjes dhe shitjes elektronike të mallrave. Si qytetarë digjitalë, ne duhet të kuptojmë që një pjesë e gjerë ose një pjesë e ekonomisë së tregut po bëhet në mënyrë elektronike. Tregtitë etike dhe të ligjshme po ndodhin. Këto transaksione shpesh janë të natyrës ilegale.

Elementi i tretë është komunikimi digjital, duke përdorur internetin si një platformë për të komunikuar. Aktualisht çdokush ka shansin të përcjellë dhe bashkohet me këdo, nga kudo në botë dhe sa herë që personi është i lidhur me një rrjet, d.m.th. internet ose rrjet telefonik.

Elementi i katërt është dija digjitale dhe procesi i mësimdhënies dhe nxënies në lidhje me teknologjinë dhe përdorimin e teknologjisë. Ndonëse shkollat kanë bërë përparime në fushën e mësimdhënie/nxënies të teknologjisë dhe inovacionit, ka ende shumë për të bërë.

Elementi i pestë është etiketimet digjitale e cila është kodi zakonor i sjelljes në shoqëri ose midis anëtarëve të një profesioni apo grupi të caktuar. Para se individët të përdorin inovacionin,

¹¹ <http://ictpd-digital-citizenship.wikispaces.com/Digital+Citizenship+in+the+classroom>.

ata duhet të mësojnë sjelljet e përshtatshme digjitale. Rregullat që vendosim nuk janë të mjaftueshme, ne gjithashtu duhet të edukojmë njerëzit për mënyrën e duhur të sjelljes.

Elementi i gjashtë është ligji digjital dhe kjo i referohet etikës që përdoruesit duhet të kenë kur përdorin teknologjinë. Rregulla të ndryshme rregullojnë fushën e përdorimit të teknologjisë, një shembull kryesor i kësaj do të ishte ligji për të drejtat e autorit që parandalon plagjiaturën. Natyrisht, ka shumë pengesa më të rëndësishme që trajtohen këtu, gjithashtu ekzistojnë “hakera” qëllimi i vetëm i të cilëve është të vjedhin informacione konfidenciale.

Të drejtat dhe përgjegjësitë digjitale është elementi i shtatë që i përket lirive të botës digjitale. Ashtu si në botën fizike për çdo qytetar janë të destinuara disa të drejta dhe përgjegjësi mbi përdorimin e teknologjisë.

Shëndeti dhe mirëqenia digjitale: mirëqenia fizike dhe psikologjike në një botë të teknologjisë digjitale është elementi i tetë. Për fat të keq, përdorimi i tepërt i pajisjes kompjuterike mund të rezultojë me probleme. Për shembull një çështje e tillë është sindroma e tunelit të kyçit të dorës e cila është një mpirje dhe ndjesi shpimi gjilpërash në dorë dhe krah të shkaktuar nga një nerv i dorës. Kjo sindromë mund të zhvillohet duke ndenjur me orë të gjata në një kompjuter. Për më tepër, kur përdor një kompjuter, një person i nënshtrohet dritës blu (drita që projektohet nga ekrani juaj). Si rezultat i ekspozimit ndaj një pamje shumë blu, shikimi i një personi mund të preken thellësisht.

Elementi i nëntë është siguria digjitale. Ashtu si në botën reale që jemi rregullisht të ekspozuar ndaj kërcënimeve të jashtme, ashtu edhe në botën virtuale ose në internet jemi të ekspozuar ndaj rreziqeve të tilla. Ka “hakera” qëllimi i vetëm i të cilëve është të mbledhin të dhënat tuaja dhe t'i përdorin ato për të mirën e tyre. Kjo mund të jetë për t'ju vjedhur ose shpifur. Duke dhënë detajet tuaja personale ose duke shkuar në një ëëbsite që është potencialisht i rrezikshëm ose është i njohur për mashtrim mund të shkojë deri atje sa të rrezikojë jetën tuaj. Si një qytetar dixhital, është detyra jonë që të veprojmë me kujdes dhe të mos japim detajet tona personale, pavarësisht se kush është personi.

8. BIBLIOGRAFIA

- ✂ UNESCO *ICT Competency Framework for Teachers*, 2018
- ✂ Korniza evropiane për kompetencën digjitale të mësuesve,
DigComEdu<https://ec.europa.eu/jrc/en/digcompedu>
- ✂ Australia: *ICT Competency Framework for Teachers*
- ✂ Dutch ICT Knowledge Base
- ✂ Teachers Competencies and Qualifications Framework for EU countries
- ✂ Chris Dede . *Implications of Neë Media for K-12 Education, Virtual Communities.*
- ✂ *Computer Technology Standards of Learning for Virginia's Public Schools*,
www.doe.virginia.gov/.../standards.../computer_technology/
- ✂ George Mason University, at the Graduate School of Education.
- ✂ Georgia Technology Standards for Educators.
- ✂ International Computer Driving License. *International Computer Driving License Syllabus Version 4.0. Dublin 4, Ireland.* European Computer Driving License: Foundation Ltd.
- ✂ International Federation for Information Processing.
- ✂ ISBE: *Technology Standards For All Teachers*
- ✂ www.castletechnology.com/CPS/.../techstrand/techstrand.html
- ✂ ISTE: *International Society for Technology in Education* (U.S. & Canada), 2008.
- ✂ Les Foltos, Director, K-12 Program. *Technology and Academic Achievement, Technology and Learning: Two Pieces of the Puzzle.* Puget Sound Center for Teaching, Learning and Technology
- ✂ Louisiana Department of Education , *Lousiana K-12 Educational Technology Standards.*
- ✂ http://www.doe.state.la.us/divisions/tech/technology_standards.html
- ✂ Muthu Kuma. *Learning with the Internet.* Senior Officer for the Centre for Research in Pedagogy and Practice at Nanyang Technological University, Singapore.
- ✂ *National ICT competency standards (NICS) for teachers.* (Tetor 2006).
- ✂ <http://www.nc.gov.ph/nics/files/NICS-Teachers>
- ✂ *Ohio Standards for the Teaching Profession.*
- ✂ www.tygerpride.com/uploaded/.../Ohio_Teacher_Standards
- ✂ Res. Ass. Tuba Gokçek, Karadeniz. *Standards for implementation of ict's (information and communication technologies) in teacher education.* Technical University, Fatih Faculty of Education, Trabzon-Turkey.
- ✂ *Teaching with Technology*, Chapman University College California Technology Standards for Teachers, Approved on May 5, 2000.
- ✂ *Computer Technology Standards of Learning for Virginia's Public Schools*, June 22, 2005.
- ✂ California ICT Standards

- ✎ Ligji për Arsimin Parauniversitar, 2012 i ndryshuar
- ✎ ISTE: *International Society for Technology in Education* (U.S. & Canada), 2008, <http://www.iste.org>.
- ✎ Education Development Center (2002). IT Career Cluster Initiative Foundation Knowledge and Skills. Ohio Department of Education.
- ✎ Georgia Technology Standards for Educators.
- ✎ IFIP . Curriculum Professional Development of Teachers.
- ✎ <http://www.edu.ge.ch/cptic/prospective/projets/unesco/en/teachers.html>
- ✎ International Computer Driving License. International Computer Driving License Syllabus Version 4.0. Dublin 4, Ireland. European Computer Driving License: Foundation Ltd.
- ✎ ISBE: Technology Standards For All Teachers.
- ✎ ISTE. National Educational Technology Standards for Teachers.
- ✎ Muthu Kuma. Learning with the Internet. Senior Officer for the Centre for Research in Pedagogy and Practice at Nanyang Technological University, Singapore.
- ✎ National ICT competency standards (NICS) for teachers. (Tetor 2006).
- ✎ NETS Standards for Teachers from ISTE, Nets for teachers 2008.
- ✎ ISTE: National Educational Technology Standards for Teachers (NETS-T)